

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI MASTER: EDUKIM INKLUZIV



TEZA MASTER

**Prevalenca e vështirësive në të nxënë tek nxënësit e ciklit
fillor**

Mentori/ja:

Prof. Ass. Dr. Ardita Devolli

Kandidati/ja:

Suada Kryeziu

Prishtinë, 2022

© [2021]-[Suada Kryeziu] Të gjitha të drejtat të rezervuara.

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij punimi është ti përgjigjet pyetjes kryesore kërkimore: Sa janë të përhapura vështirësitë në të nxënë tek nxënësit ciklit fillor? Më saktësisht, të kuptohet prevalenca e këtyre vështirësive në të nxënë tek fëmijët. Përmes literaturës, si vendase ashtu edhe ndërkombëtare, ky hulumtim ngërthen në vete faktologji dhe e zbërthen atë në mënyrën më të mirë të mundshme nga aspekti i pikëpamjes profesionale. Hulumtimi është sasior, ka një qasje analitike dhe krahasuese. Ai është realizuar në 10 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta të Komunës së Prizrenit. Si mostër e rastësishme janë 200 mësimdhënës të këtyre shkollave, mendimi i të cilëve ka qenë vendimtar për këtë hulumtim. Mbledhja e të dhënave është realizuar përmes qasjes kuantitative, ndërsa instrument matës është pyetëtori për mësimdhënës, i cili është marrë nga (NCLD, 2017) autorët e të cilit pasi kanë kryer hulumtimin e tyre siguruan se 15 milion fëmijë, adoleshentë, dhe të rritur me vështirësi në të nxënë mund të jenë të suksesshëm në shkollë, punë dhe në jetë.

Të dhënat e nxjerra nga hulumtimi janë analizuar përmes programit SPSS v.22 dhe me anë të këtyre analizave është parë korrelacioni midis vështirësive në të nxënë dhe përgatitjes profesionale të mësimdhënësve në këtë aspekt. Analizimi i të dhënave është realizuar me anë të tri testeve, respektivisht testit të korelacionit, testit H_i^2 , si dhe analizës faktoriale, teste këto që na kanë dërguar në përfundimin se, vështirësitë në të nxënë janë prezente tek nxënësit e shkollave fillore të komunës së Prizrenit. Supozimi se mësimdhënësit nuk kanë mjaftueshëm përgatitje për të trajtuar nxënësit me vështirësi të tilla është hedhur poshtë pasi që mësimdhënësit kanë dëshmuar të kundërtën. Përfundimi tjetër i nxjerrë është se disleksia dhe digrafia janë vështirësitë që hasim më shpesh tek fëmijët e shkollave fillore, mirëpo edhe diskalkulia dhe dispraksia nuk mbeten prapa. Gjatë analizave një variabël tjetër e gjetur, e cila nuk ka qenë objekt studimi, është se të tilla vështirësi ndikojnë dukshëm në performancën e fëmijëve në klasë. Gërshetimi i të gjithave ulë motivin e nxënësve për punë.

Fjalët kyçe: *disgrafi, diskalkuli, disleksi, dispraksi, performancë akademike.*

ABSTRACT

The purpose of this paper is to answer the main research question: How prevalent are learning difficulties in primary school students? More precisely, to understand the prevalence of these learning difficulties in children. Through literature and research, both domestic and international, this research incorporates the factology and decomposes it in the best possible way from a professional point of view. The research is quantitative, has an analytical and comparative approach. It was realized in 10 primary and lower secondary schools of the Municipality of Prizren. As a random sample there are 200 teachers of these schools, whose opinion has been decisive for this research. Data collection was carried out through a quantitative approach, while the measuring instrument is the questionnaire for teachers, which was taken from (NCLD, 2017) authors of which after conducting their research provided that 15 million children, adolescents, and adults with learning difficulties can be successful in school, work and in life.

The data extracted from the research were analyzed through the program SPSS v.22 and through these analyzes the correlation between the learning difficulties and the professional training of teachers in this aspect was seen. Data analysis was performed through three tests, respectively correlation test, Hi2 test as well as factor analysis, tests that have led us to the conclusion that learning difficulties are present in primary school students in the municipality of Prizren. The assumption that teachers do not have sufficient preparation to deal with students with such difficulties has been refuted as teachers have proven otherwise. The other conclusion is that dyslexia and digraphia are the most common difficulties encountered in primary school children, but even dyscalculia and dyspraxia do not lag behind. During the analysis, another variable found which has not been the subject of study, is that such difficulties significantly affect the performance of children in the classroom. The combination of all reduces the motivation of students for work.

Keywords: *dysgraphia, dyscalculia, dyslexia, dyspraxia, academic performance*

DEDIKIMI

Adorit, djalit tim.

FALËNDERIMI

Janë të shumtë njerëzit për të cilët ndjejë se duhet falenderuar, që ishin pranë meje gjatë këtij rrugëtimi, i cili kërkon kohë dhe përkushtim dhe kjo është arritur me përkrahjen e familjarëve, profesorëve dhe kolegëve, për të cilët doja t'u shprehja mirënjohjen time më të sinqertë.

Si fillim dua të falenderoj gjithë stafin e Departamentit të Edukimit, të cilët kanë dhënë shumë në ngritjen time profesionale. Një falenderim i veçantë shkon për mentoren time Prof. Ass. Dr. Ardita Devolli, e cila më motivoi shumë me njohuritë që kishte dhe hulumtimet që kishte bërë ajo lidhur me vështirësitë në të nxënë, më shtynë që sado pak dhe unë të kontribuoj në këtë fushë. E falenderoj gjithashtu edhe për ndihmën dhe mbështetjen e çmuar që më ofroi përgjatë punës sime, e cila nuk kurseu në asnjë moment kohën e saj për të më këshilluar që në fund ky punim të kishte një paraqitje sa më dinjitoze. Falenderoj poashtu anëtarët e komisionit Prof. Asoc. Dr. Naser Zabeli dhe Prof. Ass. Dr. Blerim Saqipi për vlerësimin e temës.

Gjithashtu falenderoj kolegët e mi, me të cilët kemi pasur bashkëpunim të ngushtë gjatë kësaj periudhe shkollimi, veçanërisht dy koleget e mija Ardora Haskuka dhe Mjellma Shala me të cilat kam pasur një bashkëpunim më të ngushtë dhe së bashku kemi krijuar shumë kujtime të bukura.

Dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, një falenderim i madh është për familjen time, të cilëve iu detyrohem aq shumë, për përkrahjen e tyre rezervë, që gjithmonë më shtynë të eci përpara.

Ju faleminderit!

PËRMBAJTA

I. Hyrja	2
Qëllimi i hulumtimit	5
Pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza.....	5
II.SHQYRTIMI I LITERATURËS	6
Këndvështrim i përgjithshëm mbi vështirësitë në të nxënë	6
Disleksia (vështirësia në të lexuar)	10
Disgrafia (vështirësia në të shkruar)	13
Diskalkulia (vështirësia në matematikë).....	15
Dispraksia (vështirësia në lëvizje)	17
III. METODOLOGJIA	19
Mostra	19
Instrumenteti hulumtues.....	20
Procedura e mbledhjes së të dhënave.....	20
IV. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET	22
Rezultatet deskriptive.....	22
Vërtetimi i hipotezave.....	65
Testimi i hipotezës së parë.....	65
Testimi i hipotezës së dytë.....	66
Testimi i hipotezës së tretë.....	68
V. DISKUTIMI DHE KONKLUZIMET	77
Kufizimet e studimit	80
Hulumtimet në të ardhmen.....	80
Implikimet praktike nga studimi.....	81
REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE	82
SHTOJCA: PYETËSORI I MËSIMDHËNËSVE.....	87

Lista e tabelave

Tabela 1. Përshkrimi i mostrës së hulumtimit	19
Tabela 2. Karakteristikat përshkruese të respondentëve.....	23
Tabela 3. Respondentët sipas regjionit.	24
Tabela 4. Gjinia e respondentëve.....	24
Tabela 5. Respondentët sipas nivelit të shkollimit.....	25
Tabela 6. Moshës e respondentëve.	25
Tabela 7. Përvoja e punës së mësimdhënësve.	26
Tabela 8. Ka vështirësi në organizimin e aktiviteteve	30
Tabela 9. Shpërqendrohet lehtë nga ndikimet e jashtme	31
Tabela 10. I harron shpejtë aktivitetet e përditshme/rutinore.	31
Tabela 11. Është i ngathët, derdh dhe rrëzon gjëra nga duart.....	32
Tabela 12. Nuk ka sukses në aktivitete që kërkojnë koordinimin e syve me duart.	33
Tabela 13. Nuk arrin të kryejë aktivitete që kërkojnë shkathtësi të gishtave.	33
Tabela 14. . Mban lapsin në mënyrë jo të duhur, si rezultat ka shkrim të dobët.	34
Tabela 15. Ka vështirësi në përdorimin e objekteve të vogla.....	35
Tabela 16. Demonstron vonesa në të folur	35
Tabela 17. Ka vështirësi të ritregojë atë që sapo është thënë.....	36
Tabela 18. Demonstron të folur të ngadaltë dhe të ndërprerë.....	37
Tabela 19. Ngatërron fjalët që tingëllojnë të ngjashme.	37
Tabela 20. Ka interes të kufizuar për libra ose tregime.	38
Tabela 21. Ka vështirësi për të kuptuar udhëzimet e detyrave.	38
Tabela 22. Ka vështirësi në njohjen dhe kuptimin e fjalëve të reja.	39
Tabela 23. Shpesh humbet vendin gjatë leximit.	40
Tabela 24. Ndryshon rendin e shkronjave në fjalë.	40
Tabela 25. Ka probleme në emërtimin e shkronjave.	41
Tabela 26. Zëvendëson ose shmang disa fjalë gjatë leximit.....	42
Tabela 27. Nuk i pëlqen të lexojë.	42
Tabela 28. Demonstron vonesa për të kopjuar dhe shkruar tekste të ndryshme.....	43

Tabela 29. Vështirë i kujton si duken shkronjat dhe numrat.	43
Tabela 30. Shpesh i përmbysë shkronjat, numrat dhe simbolet.....	44
Tabela 31. Kopjon nga tabela në mënyrë të pasaktë.....	45
Tabela 32. Ka vështirësi të shoqërohet me moshatarët.....	45
Tabela 33. Nuk reagon si duhet ndaj ngacmimeve.....	46
Tabela 34. Ka vështirësi me vetëkontrollin kur zhgënjehet.....	46
Tabela 35. Shfaq vështirësi në njohuritë mbi numrat.....	47
Tabela 36. Ka vështirësi për të mësuar mbledhjen dhe zbritjen.....	48
Tabela 37. Rendit dobët numrat duke bën gabime llogaritëse.....	48
Tabela 38. Ka vështirësi të bëj krahasime.....	49
Tabela 39. Ka vështirësi mbi konceptin e kohës.....	49
Tabela 40. Ka vështirësi të numërojë shpejt ose të bëjë llogaritjet.....	50
Tabela 41. Ka vështirësi në të mësuarit e tabelave të shumëzimit.....	51
Tabela 42. Nxënësit identifikohen lehtë me vështirësi në të nxënë.....	52
Tabela 43. Vështirësitë në të nxënë janë të lindura.....	52
Tabela 44. Puna e mësimdhënësve zbut vështirësitë në të nxënë tek nxënësit.....	53
Tabela 45. Nxënësit shfaqin më shumë vështirësi në lexim.....	54
Tabela 46. Nxënësit shfaqin më shumë vështirësi në shkrim.....	54
Tabela 47. Nxënësit shfaqin më shumë vështirësi në matematikë.....	55
Tabela 48. Nxënësit shfaqin më shumë shenja të dispraksisë.....	55
Tabela 49. Mendoj se në shkollat tona janë të përhapura vështirësitë në të nxënë.....	56
Tabela 50. Analiza mbi shfaqjen e dispraksisë tek nxënësit.....	57
Tabela 51. Analiza mbi shfaqjen e disleksisë tek nxënësit.....	59
Tabela 52. Analiza mbi përhapjen e vështirësive në të nxënë në shkollat fillore.....	62
Tabela 53. Testit H_i^2 për hipotezën e parë.....	65
Tabela 54. Testi Pearson Chi-Square.....	66
Tabela 55. Testi i korrelacionit për hipotezën e dytë.....	67
Tabela 56. Testi KMO për hipotezën e tretë.....	68
Tabela 57. Klasifikimi i ndryshoreve.....	69
Tabela 58. Kategoritë e ndryshoreve.....	72

Lista e figurave

Figure 1. Shkolla pjesëmarrëse në hulumtim.....	27
Figura 2. Vendi i të anketuarve sipas zonës.....	27
Figura 3. Mosha e respodentëve.	28
Figura 4. Gjinia e respodentëve.	28
Figura 5. Niveli i shkollimit.....	29
Figura 6. Përvoja e të anketuarve.....	29
Figura 7. Analiza mbi shfaqjen e dispraksisë.	58
Figura 8. Analiza mbi shfaqjen e disleksisë.....	61
Figura 9. Analiza mbi prevalencën e vështirësive në të nxënë.	64
Figura 10. Testi HI^2 për hipotezën e parë.	65
Figura 11. Testi i korrelacionit për hipotezën e dytë.	67
Figura 12. Lakorja e ndryshoreve.	71

I. Hyrja

Jeta dhe shkolla përbëhet nga një sërë ngjyrash dhe laramanish njerëzore. Heterogjeniteti i nevojave dhe aftësive e vë shkollën përballë sfidave të vazhdueshme të cilat ashtu sikurse njerëzimi janë në evoluim të vazhdueshëm. Në përputhje me nevojat dhe aftësitë e gjithësecilit, shkolla ofron një mjedis të përshtatshëm ose thënë ndryshe ofron arsim gjithëpërfshirës. Gjithëpërfshirja në arsim ka si synim përfshirjen e të gjithë fëmijëve pa dallim race, gjinie, etnie, aftësie të kufizuar apo ndonjë dallim tjetër në shkollën më të afërt të rregullt. Duke i dhënë nxënësit një feedback pozitiv në klasë, duke e lavdëruar për arritjet, por mbi të gjitha duke vlerësuar për përpjekjet e tij, nxënësi me vështirësi në të nxënë nxitet të jetë më aktiv dhe të marrë pjesë me më shumë dëshirë në aktivitete shkollore. Gjithëpërfshirja në të shumtën e rasteve është e lidhur me mospërrjashtimin social. Ajo zakonisht është e përkufizuar si një shoqëri, në të cilën të gjithë individët ndihen të vlerësuar dhe nevojat e tyre themelore janë të plotësuara, përkundër dallimeve të tyre, pasi që dallime të tilla respektohen dhe trajtohen si faktorë kontribues të diversitetit (Robo, 2014).

Duke qenë se përjashtimi ndodh shumë herët në jetë, arsimi gjithëpërfshirës është një nga mekanizmat më të rëndësishëm, që do të sigurojë promovimin dhe zgjerimin e konceptit të gjithëpërfshirjes. Për më tepër gjithëpërfshirja konsiderohet si një nga kërkesat thelbësore për një shoqëri demokratike dhe kontribon fuqishëm në kontekstin e shëndetit mendor (Lipsky, 1999). Sipas UNICEF-it arsimi gjithëpërfshirës nënkupton një sistem arsimor që përfshinë të gjithë nxënësit, i mirëpret dhe i mbështet ata për të mësuar pavarësisht aftësive dhe nevojave të tyre, askush nuk përjashtohet nga shkolla, të gjithë janë pjesë e saj duke përfshirë edhe fëmijët me vështirësi në të nxënë (UNICEF, 2017). Çdo shkollë ka kulturën e vet e cila përcakton edhe qasjen e mësimdhënësve në punën me fëmijët, e veçanërisht me ata me vështirësi në të nxënë.

Gjatë një studimi të kryer është vërtetuar se, nëse në një shkollë ka mësues që punon me nxënës me vështirësi në të nxënë atëherë edhe kolegët automatikisht stimulohen që të pranojnë të tillë nxënës në klasat e veta, një angazhim i tillë dhe qëndrime pozitive mund të prishë rezistencën e mentalitetit të vjetër me shkolla speciale (Dupoux, 2006). Udhëtimi për t'u bërë një "shkollë gjithëpërfshirëse" mund të jetë i gjatë dhe sfidues ndonjëherë, por në fund ky udhëtim e forcon komunitetin shkollor dhe është në dobi të të gjithëve. "Përfshirja" nuk nënkupton vetëm

futje e nxënësve me vështirësi në klasa të rregullta, por ky proces nënkupton ndryshime thelbësore në mënyren se si komuniteti shkollor mbështet nevojat e secilit nxënës. Në shkollat e tilla jo vetëm që përfitojnë nxënësit me vështirësi në të mësuar, por edhe nxënësit pa të tilla vështirësi kanë mundësi të lulëzojnë (Gerondale, 2015). Gjithëpërfshirja si filozofi arsimore është relativisht e re në Kosovë, edhe si koncept edhe si praktikë. Ky koncept dhe kjo praktikë ka ardhur në Kosovë pas vitit 1999 bashkë me reformat tjera arsimore. (MASHT, 2014).

Të lexuarit, shkrimi e shqiptimi rezultojnë të jenë detyra komplekse për fëmijët, madje edhe për shumicën dërmuese që i mësojnë këto procese pa shumë vështirësi. Por për disa të tjerë shkronjat, numrat, rrokjet, fjalët, veprimet e thjeshta matematikore, mund të kthehen në labirinte të vërteta duke shfaqur kështu ato që klasifikohen si çrregullime në të nxënë (Garuli, 2018).

Kohëve të fundit ka ndodhur një vetëdijësim më i madh i popullatës lidhur me këto vështirësi pasi që tani kemi mënyra të shumta dhe të shpejta për marrjen e informacioneve relevante. Nga hulumtime të ndryshme në SHBA konsiderohet se rreth 5% e nxënësve të shkollave publike (2.7 milionë nxënës) janë të prekur nga një vështirësi e të nxënit dhe se gjysma e nxënësve me nevoja të veçanta të cilët marrin mbështetje dhe trajtim, janë ata me vështirësi në të nxënë (Pierangelo, 2010).

Në kapitujt në vazhdim do të shqyrtohet literatura sa i përket vështirësive në të nxënë, e cila është marrë nga autorë të ndryshëm si vendas ashtu edhe të huaj, përfshirë këtu libra e hulumtime të ndryshme shkencore. Pas literaturës kapitulli i radhës përmban metodologjinë e punës në të cilën përfshihet mostra e hulumtimit dhe instrumenti matës. Poashtu shpjegohen edhe testet e ndryshme që janë përdorur me anë të programit SPSS v.22 për analizimin e të dhënave që na dërgojnë deri tek rezultatet e punimit. Pas analizimit të të dhënave kapitulli i katërt shpjegon konkludimet e nxjerra nga hulumtimi i zhvilluar, ndër të tjerash në këtë kapitull pëfshihen kufizimet e hulumtimit si dhe hulumtimet që mund të realizohen në të ardhmen duke u bazuar nga po i njejti hulumtim. Dhe kapitulli i fundit i këtij punimi janë shtojcat ku pjesë e tij është pyetësori me pohime që ndihmojnë hulumtimin.

Kjo temë është e rëndësishme për t'u hulumtuar pasi që është mjaft aktuale në ditët e sotme, gje që më ka shtyer mua të hulumtoj mbi këtë, si dhe duke pasur parasysh se kjo dukuri është shfaq te shumë fëmijë, e cila i ka penalizuar ata për arritje më të larta në mësim.

Sigurisht që kjo temë është trajtuar edhe shumë më herët në vendin tonë, ndër tjerash është edhe punimi i doktoratës së profesoreshës Ardita Devolli, në të cilin na thotë se: “Në shkollat tona, përkatësisht në kategorinë e nxënësve të moshës fillore, ekziston një numër i konsiderueshëm i nxënësve me vështirësi në lexim dhe shkrim. Mësimdhënësi që punon me ta nuk ka kohë, mundësi e përgaditje profesionale për t’u dalë në ndihmë këtyre nxënësve siç duhet dhe kërkojnë ata“ (Devolli, 2008). Punim nga i cili janë bazuar dhe dy nga hipotezat që kam parashtruar për vërtetim.

Ky kapitull pra na jep një pasqyrë të përgjithshme të gjithëpërfshirjes dhe situatës aktuale të vështirësive në të nxënë në Kosovë. Kapitulli i dytë na ofron një përmbledhje të hollësishme të literaturës si vendase ashtu edhe ndërkombëtare, lidhur me prevalencën e vështirësive në vend, rajon dhe botë, pasqyron njohuritë e mësimdhënësve lidhur me punën me këta fëmijë si dhe vështirësitë që hasin ata gjatë këtij rrugëtimi.

Pjesa e tretë trajton metodologjinë e punës së përdorur gjatë gjithë hulumtimit. Hulumtimi në fjalë është i tipit sasior, i cili ka një qasje analitike dhe krahasuese, mostër e së cilit janë 200 mësimdhënës të ciklit fillor në 15 shkolla të rajonit të Prizrenit. Instrumenti matës është pyetësori me pyetje për mësimdhënës, në të cilin mësimdhënësit kanë shprehur mendimin e tyre, veprim ky që ka qenë vendimtar në këtë hulumtim. Në kapitullin e katërt paraqitet analiza e të dhënave dhe rezultatet e nxjerra përmes metodave statistikore në programin SPSSv. 22. Pas analizimit të të dhënave kemi ardhë në përfundim se vështirësitë në të nxënë kanë një prevalencë të lartë në shkollat pjesëmarrëse në hulumtim, rezultatet treguan gjithashtu se mësimdhënësit janë të informuar mjaftueshëm për këto vështirësi, si dhe në fund kemi arritur në konkluzion se jo vetëm disleksia dhe disgrafia janë të pranishme por edhe shenjat e diskalkulisë dhe dispraksisë ndjehen në këto 15 shkolla. Si kufizime të hulumtimit konsideroj, numrin e kufizuar të shkollave pjesëmarrëse, duke shtuar numrin e shkollave rritet edhe saktësia e rezultateve.

Vitet e fundit vështirësitë specifike në të nxënë janë mjaft aktuale nëpër shkolla vendore dhe ndërkombëtare. Prandaj ky punim shkencor ka për qëllim të vë në pah prevalencën e vështirësive në të nxënë tek nxënësit si dhe ndikimin e tyre në arritjet akademike si dhe të kuptoj njohuritë e mësimdhënësve në këtë aspekt, duke e marrë parasysh faktin se mësimdhënësit ndeshen vazhdimisht me punën me këta fëmijë, gjë që e bën punën e tyre akoma edhe më sfiduese.

Qëllimi i hulumtimit

Duke marrë parasysh rolin kyç të mësimeve në procesin mësimor, përgatitja profesionale e tyre ndikon në menaxhimin e situatave me nxënës të tillë në klasë. Nisur nga të gjitha këto, ky hulumtim ka për qëllim të arrijë të kuptojë prevalencën e vështirësive në të nxënë tek nxënësit e ciklit fillor.

Pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza

Pyetjet kërkimore të këtij punimi janë:

1. *Sa janë të përhapura vështirësitë në të nxënë tek nxënësit e ciklit fillor?*
2. *Sa janë të përgatitur mësimeve për trajtimin e mirëfilltë të këtyre vështirësive?*
3. *Cilat prej vështirësive në të nxënë janë më shpesh të shfaqura tek nxënësit?*

Duke u bazuar në pyetjet e hulumtimit janë parashtruar tri hipoteza:

H1 - Vështirësitë në të nxënë janë të përhapura në masë të madhe tek nxënësit e ciklit fillor.

H2 - Mësimeve nuk kanë përgatitje të mjaftueshme profesionale për trajtimin e duhur të këtyre vështirësive.

H3 - Disleksia dhe disgrafia janë vështirësitë më të përhapura tek nxënësit.

Kapitulli I dha një pasqyrë të situatës aktuale në Kosovë dhe një arsyetim për kryerjen e këtij studimi. Ky kapitull përfundon me paraqitjen e pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të studimit. Kapitulli II ofron një përmbledhje të hollësishme të literaturës, duke përfshirë pasqyra të studimeve dhe kërkimeve mbi konceptet e prevalencës së vështirësive në të nxënë tek nxënësit e ciklit fillor. Në Kapitullin III, përshkruhet metodologjia e hulumtimit duke përfshirë karakteristikat e mostrës, instrumentet, metodat e mbledhjes së të dhënave, si dhe qasja ndaj analizës. Kapitulli IV paraqet në detaje gjetjet e studimit Në fund, Kapitulli V diskuton gjetjet, nxjerrë konkludimet kyçe, shtjellon pikat e forta dhe kufizimet e studimit, udhëzimet e ardhshme për kërkime dhe implikimet për praktikën e ardhshme.

II.SHQYRTIMI I LITERATURËS

Këndvështrim i përgjithshëm mbi vështirësitë në të nxënë

Vështirësitë në të nxënë tek nxënësit paraqesin pamundësinë e përvetësimit të drejtë të shkathtësive akademike si: shkrimit, leximit, zgjedhjes së problemeve matematikore si dhe kordinimit të lëvizjeve motorike. Hulumtime të ndryshme tregojnë se në çdo vend të botës ka përqindje të mjaftueshme të vështirësive në të nxënë. Pa shkuar shumë larg në Itali, në një studim me një kampion prej 1774 nxënësish në 94 klasa të katërta të fillores, rezultatet treguan se prevalenca e vështirësive në të nxënë është rreth 3.2% (Barbiero, 2012).

Disa prej karakteristikave të fëmijëve me vështirësi në të nxënë janë:

- Vetëbesim i ulët
- Vetëkoncept jo pozitiv
- Kanë ndjenja ankthi dhe frustrimi
- Të brishtë emocionalisht
- Lodhen shpejtë dhe ndihen të pazotë (Garuli, 2018).

Vështirësitë në drejtshkrim, lexim, matematikë mund të manifestohen në forma të ndryshme përgjatë ecurisë shkollore të një nxënësi. Ato mund të jenë vetëm të një lloji apo të kombinohen e të bashkëshoqërohen me njëra tjetrën. Përgjigjja që i jep fëmija kësaj, situatës së vet, dhe parahatisë që këto vështirësi shkaktojnë, lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me vetëvlerësimin dhe konceptin për veten. Rruga që zgjedh fëmija për t'ju përshtatur performancës së tij shkollore shpesh perceptohet gabimisht nga të rriturit si mungesë motivimi, mungesë dëshire, dembelizëm apo mosangazhim në detyra shkollore (Erickson, 2013).

Në këto kushte fëmija vendoset vazhdimisht nën trysni nga prindërit dhe mësuesit, duke u gjendur përballë përgjegjësive që nuk bëjnë gjë tjetër vetëm sa i përkeqësojnë problematikat e fëmijës dhe rëndojnë simptomat e vështirësisë. Të gjitha këto presione mbi fëmijën ndikojnë jo vetëm në performancë akademike në shkollë, por edhe kanë ndikim tejet të madh mbi gjendjen emocionale e psikologjike të tij (Garuli, 2018).

Sipas Reid-it ndërhyrja e hershme rezulton të jetë e suksesshme në 90-95% të rasteve, duke parandaluar kështu përparimin e mëtejshëm të vështirësisë dhe shumica e këtyre nxënësve do të arrijnë një nivel lektor, shkrimi apo shkathtësish matematikore në një nivel afër parametrave të normës. (Reid, 2006). Një mendim të tillë e përkrahin edhe Weilland dhe Yoshikawa ku thonë se ka shumë hapësira për ndërhyrje të menjëhershme duke qenë se fëmijët janë të përfshirë në shumë aktivitete e lojëra të ndryshme; pra ndërhyrja e menjëhershme mund të vijë në formë të argëtimit (Weilland, 2013).

Sipas Manualit diagnostikues dhe statistikor të çrregullimeve psikologjike DSM-V, vështirësitë e të nxënësve bëjnë pjesë të grupi i çrregullimeve neurologjike të zhvillimit, bashkë me ato të komunikimit dhe motorike (American Psychiatric Association, 2013). Më poshtë renditen çrregullimet përkatëse të të nxënësve sipas DSM-V me tipologjitë, specifikat dhe karakteristikat e secilit prej tyre:

- A. Vështirësi në të nxënë dhe në përdorimin e shprehive akademike, të cilat janë vënë në dukje nga prania e të paktën një prej simptomave të mëposhtme, që kanë vazhduar të jenë të pranishme për të paktën 6 muaj, pavarësisht ndërhyrjeve në drejtim të këtyre vështirësive.
1. Lexim i pasaktë apo i ngadaltë i fjalëve dhe në mënyrë të sforcuar (p.sh. mund të lexojë fjalët me zë të lartë, me gabime dhe duke i ndarë në rrokje, vështirësi për të shprehur mirë fjalët).
 2. Vështirësi për të kuptuar domethënien e asaj që lexon, mund ta lexojë një tekst me saktësi por nuk arrin të identifikojë kuptimin e plotë dhe të thellë të asaj që po lexon.
 3. Vështirësi ortografike, p.sh. mund të shtojë, të heqë apo të zëvendësojë zanore a bashkëtingëllore.
 4. Vështirësi për të shprehur me shkrim, p.sh. bën shumë gabime gramatikore apo pikësimi, nuk e sistemon mirë mendimin nëpër paragrafe e fjali, idetë nuk janë të shprehura në mënyrë të qartë.
 5. Vështirësi për të përvetësuar kuptimin dhe përdorimin e shifrave, të dhënat e shprehura me numra ose llogaritje, p.sh. i kupton gabim numrat, njesitë dhe marrëdhëniet mes tyre,

numëron me gishta për të mbledhur numrat njëshifrorë, hutohet dhe përhumbet në llogaritjet matematikore dhe i ndërron vendin numrave gjatë veprimeve me to.

6. Vështirësi me arsyetimin matematikor (p.sh. ka shumë vështirësi për të zbatuar në praktikë konceptet teorike matematikore gjatë zgjedhjes së problemeve aritmetike).

B. Shprehitë dhe aftësitë akademike të dëmtuara janë cilësisht më të ulëta sesa niveli mesatar i moshës kronologjike të individit, ndërhyjnë në rendimentin shkollor apo të jetës së përditshme dhe evidentohen me prova e matje të standardizuara dhe të administruara gjatë procesit të vlerësimit. Tek individët mbi 17 vjeç, historiku i dokumentimit të vështirësive në të nxënë mund të zëvendësohet me vlerësime përkatëse.

C. Vështirësitë në të nxënë shfaqen në moshën shkollore, por mund të mos dalin në pah plotësisht deri në çastin kur kërkesat akademike tejkalojnë aftësitë e dëmtuara të individit (p.sh. në provime përfundimtare, gjatë leximit apo hartimit me shkrim të detyrave të gjata e komplekse të përcaktuara me afate).

D. Vështirësitë në të nxënë nuk shpjegohen ndryshe nga defiçite vizuale apo auditive, nga prapambetja mendore, nga çrregullime të tjera zhvillimi apo neurologjike, nga dallime psiko-sociale, apo nga edukimi dhe orientimi i papërshtatshëm akademik.

E. Duhet të plotësohen këto katër kritere që individi të diagnostifikohet me ndonjërin prej vështirësive duke ia shtuar këtu edhe një sintezë klinike të historikut të individit (të zhvillimit, mjekësor, familjar dhe edukativ).

Disa prej sjelljeve që mund të na parathënë praninë e vështirësive të të nxënit janë:

- Ngatërrimi i ditëve të javës
- Ngatërrimi i muajve, stinëve dhe sekuencave kohore
- Vështirësi në mbajtjen mend të datave
- Ngatërrimi i të majtës dhe të djathtës
- Vështirësi në përceptimin e koncepteve të vendndodhjes (brenda-jashtë, lartë-poshtë)
- Vështirësi të mbajtjes mend të sekuencave kohore (përpara-pas, dje-nesër)
- Vështirësi në memorizimin e renditjes numerike
- Vështirësi në përvetësimin e konceptve të kohës dhe orës
- Vështirësi në aktivitetet sportive ku kërkohet koordinimi i lëvizjeve të duarve, këmbëve (basketboll, volejball, futboll)
- Vështirësi në ndjekjen e ritmeve muzikore
- Vështirësi në përdorimin e gërshërëve, në ngjyrosjen brenda modeleve, dhe kopjimin e një vizatimi
- Vështirësi në lidhjen e këpucëve apo mbërthimit të kopsave
- Mungesë interesi ndaj lodrave puzzle apo me pjesë ndërtuese (lego)
- Mungesë vëmendje harron dhe prishë lodrat dhe mjete të ndryshme shpesh
- Vështirësi të mbajtjes mend të rimave dhe vjershave
- Riprodhojnë fjalër në mënyra të ndryshme, ndërtojnë fjali duke i vendosur fjalët në rendin e gabuar, harrojnë lehtësisht atë që ishin duke thënë
- Vështirësi në vizatim (Savelli, 2011).

Do të ishte shumë më mirë sikurse të gjithë të mendonim se fëmijët me vështirësi në të nxënë nuk kanë çrregullime, por kanë një mënyrë tjetër të të mesuarit. Vlersimi i diversitetit, barazia për ti dhënë gjithëkujt mundësinë për t'u rritur dhe bashkëpunuar në grup janë ndër parimet themelore që duhet të kenë parasysh profesionistët që punojnë me fëmijë me vështirësi në të nxënë.

Në vazhdim po japim disa nga specifikat më të rëndësishme të vështirësive në të nxënë.

Disleksia (vështirësia në të lexuar)

Etimologjia e kësaj fjale që shpreh çrregullim do të thotë vështirësi në të folur ose shqiptim. Në fakt disleksia ka të bëjë me vështirësi që manifestohen në fushën e të shkruarit, leximit, drejtshkrimit e drejtshqiptimit, ku veçanërisht fëmijët nuk arrijnë të bëjnë mirë dallimin mes shkronjave, nuk i memorizojnë dot ato, nuk bashkojnë saktësisht rrokjet e fjalëve dhe nuk strukturojnë mirë fjalët nëpër fjali. Në këtë mënyrë leximi dhe shkrimi i tyre rezulton i pasaktë e me gabime (Garuli, 2018). Është vështirësi në të nxënë që nuk ka të bëjë me kapacitetin intelektual, e cila shpesh paraqet një problem të vështirë por edhe jo të patrajtueshëm. Vështirësitë e disleksisë sipas Goswamit shpjegohen me anë të defiçiteve që mund të kenë fëmijët disleksikë në perceptimin dhe në përpunimin shqisor të informacioneve, duke shtuar mungesën e përvojës dhe ushtrimit të duhur të veprimtarive të të lexuarit dhe të shkruarit (Goswami, 2015).

Disleksia përmban karakteristika të cilat nuk shfaqen të gjitha në të njëjtën kohë. Duke qenë se shumica e tyre lidhen me kontekstin shkollor, karakteristikat kryesore të disleksisë do të manifestohen me kohën në mënyra të ndryshme. Megjithatë, performanca e ulët në aftësitë dhe shprehitë kognitive që në moshën parashkollore, të cilat lidhen me kujtesën verbale afatshkurtër, zhvillimin dhe fleksibilitetin në aspektin fonologjik të gjuhës së shprehur dhe perceptimin vizual, janë në njëfarë mënyre parashikuese të disleksisë (Carroll, Jonathan, & Shapiro, 2015).

Është e vështirë të specifikohet një shkak i vetëm në rastet e disleksisë, pasi në përgjithësi shfaqja e disleksisë tek fëmijët vjen si rrjedhojë e kombinimit të dy faktorëve kryesorë: faktori neurologjik dhe atij kognitiv.

Faktori neurologjik - Clark dhe autorë të tjerë na bëjnë me dije se në rastin e lexuesve tipikë, rrjetet neuronale janë të bashkëlidhura më mirë dhe funksionojnë në mënyrë më të bashkërenduar sesa në rastin e lexuesve disleksikë. Imazhet që vijnë nga rezonancat magnetike të trurit në rastet me disleksi, kanë treguar se në nivel neuroanatomik defiçitet nuk janë konkretisht në proceset e të lexuarit, por më shumë tek funksionet ekzekutive të lidhura me procesimin vizual dhe auditiv të informacionit (Clark, Helland, Specht, Narr, & Mains, 2014).

Faktori kognitiv - perceptimi i stimujve vizuel, përpunimi i informacionit, dekodimi i mesazheve verbale dhe kujtesa e punës janë disa prej shumë elementëve kognitivë të pranishëm

në proceset e gërmëzimit, leximit, drejtëshkrimit, dhe riprodhimit lingvistik. Evidenca nga studime të ndryshme tregojnë se fëmijët disleksikë kanë vështirësi në perceptimin e stimujve vizualë, por jo kur këta janë të shkëputur, por kur shoqërohen prej atyre verbalë. Do të thotë që këta fëmijë nuk kanë vështirësi në identifikim vizual të shkronjave apo rrokjeve, por në rast se ato etiketohen si fjalë apo emërtime, atëherë ata shfaqen të paqartë në lexim, pra problemi i tyre nuk është konceptual por teknik (Garuli, 2018).

Shtrohet pyetja se a është disleksia e trashëgueshme apo varet nga stimujt e ambientit ku vepron?

Shumë studime janë fokusuar për ti dhënë përgjigje kësaj pyetje, në njërin nga këto thuhet se prindërit e fëmijëve disleksikë shfaqin profile të ndryshme kognitive, emocionale dhe sjellore, krahasuar me prindërit e tjerë tipikë (Bonifacci, 2013). Mbështetur nga kjo kuptojmë se këta prindër shfaqin predispozita të mos jenë të mirë në lexim dhe kështu nuk mund të ndihmojnë fëmijët e tyre ose ti orientojnë ata si duhet. Pra ajo që mund të jetë faktor trashëgues automatikisht shëndrohet në faktor mjedisor të pafavorshëm. Një grup studiuesish holandezë ndoqën 180 fëmijë të cilët vinin nga familje me njërin prej prindërve, vëllezërve apo motrave më të mëdhenjë që janë disleksikë dhe paralelisht ndoqën 120 fëmijë të cilët nuk kishin asnjë predispozitë gjenetike për të shfaqur disleksi. Dy grupet u monitoruan paralelisht prej moshës 2 muajsh deri 9 vjeç lidhur me zhvillimin gjuhësor, vizual, kognitiv dhe më vonë shprehitë e lexim-shkrimit. Ajo që u vu re nga e gjithë kjo ishte se fëmijët që vinin nga një sfond familjar disleksik kishin performancë më të ulët në aspekte të gjuhës së shkruar dhe asaj të shprehur (Van der Leij, 2013). Paralelisht me këtë fakt evidencat tregojnë se prindërit e fëmijëve disleksikë të cilët mund të kenë pasur problematika në ecurinë shkollore sa i takon të nxënës, janë gjithashtu individ të rritur të cilët edhe për vete lexojnë shumë pak ose aspak (Snowling, 2016).

Një pyetje tjetër që ka zgjuar kureshtjen e njerëzve është se: *A është shfaqja e disleksisë e njejtë në të gjitha gjuhët e botës?* Studime të shumta na kanë treguar se lexuesit e gjuhëve alfabetike siç është gjuha angleze, vështirësitë në lexim dhe shkrim janë më të mëdha sesa në gjuhët logografike siç është gjuha kineze (Siok, 2008). Prej gjuhëve alfabetike është edhe gjuha shqipe, prandaj edhe nxënësit shqiptarë futen në grupin e disleksikëve dhe disgrafikëve më të mëdhenjë.

Pasi fëmijët dhe lexuesit tipik e përvetësojnë procesin e të lexuarit përmes dy rrugëve asaj vizuale dhe fonologjike, atëherë në bazë të rrugës së leximit që dominon, disleksitë ndahen në dy lloje: disleksia fonologjike – përdoret rruga vizuale e të lexuarit, si dhe disleksia vizuale – në të cilën përdoret rruga fonologjike e të lexuarit (Weiland, 2013). Nxënësi me disleksi fonologjike ka disa prej këtyre veçorive:

- Vështirësi për të lexuar fjalë të reja dhe të panjohura;
- Zëvendësimi i disa fjalëve të vështira me disa të tjera të ngjajshme;
- Vështirësi në kujtesën e punës gjatë kryerjes së aktiviteteve shkollore;
- Mospërdorim i drejtë i fjalorit;

Ndërsa ajo vizuale ka disa prej këtyre karakteristikave:

- Lexim shumë i ngadaltë;
- Gabime të shumta ortografike;
- Vështirësi në orientim, majtas-djathtas, në emërtime, në matematikë etj. (Garuli, 2018).

Për të kuptuar që kemi disleksi në fillim marrim informacione lidhur me anamnezën personale, e pastaj fillohet me vlerësimin neuropsikologjik: perceptimi, aftësitë motorike, funksionimi kognitiv, psikomotorika, funksionimi psikolinguistik, gjuha dhe zhvillimi emocional të cilat maten përmes testeve të ndryshme si p.sh. testi Bender i cili ka të bëjë me riprodhimin e figurave gjeometrike që paraqiten me radhe, pastaj kemi testin e inteligjencës WISC-R i cili ndahet në dy pjesë, pjesa e cila ka të bëjë me veprime numerike, aritmetike, simbole e sidomos në pjesën gjuhësore, fëmijët disleksikë marrin më pak pikë, pastaj kemi testet ITPA-3 (Illinois Test of Psycholinguistic Abilities, 2001) dhe PPVT (Peabody Picture Vocabulary Test, 1986), të cilat vlerësojnë konstruktin polilinguistik, masin pasurimin e fjalorit të individit etj. (Garuli, 2018). Disleksikët problemin më të shpeshtë të cilin e shprehin ka të bëjë me gjuhën e folur dhe të shkruar, e cila vlerësohet përmes vëzhgimit të këtyre elementeve, shkurtimet (p.sh. libër-libë), kthimet (muri-rumi), zëvendësimet (pjtë-platë), shtime (fletë-fletëra), ngatërrimet etj. Pastaj vëzhgohet me kujdes ritmi i të lexuarit, a është i ngadaltë, i shpejtë, normal apo linear, si dhe shqyrtohet niveli i të lexuarit a është mekanik apo i jep kuptim asaj që lexon, a i respekton shenjat e pikësimit, pra a është një lexim logjik (Duff, 2014). Vështirësitë emocionale janë dytësore te këta fëmijë por gjithsesi duhet të zënë një vend në çastin e planifikimit të strategjive

të ndërhyrjes. Studime të ndryshme tregojnë se këta fëmijë qysh para se të hynë në shkollë shfaqin socializim të varfër, prandaj pas anamnezës është e rëndësishme edhe historiku i zhvillimit emocional (Parhiala, 2015).

Me kalimin e viteve ashtu sikurse ndryshon personi, ashtu edhe ridimensionohet disleksia, duke qenë se nxënësi adoleshentë mundohet gjatë gjithë kohës ti mbulojë dobësitë e veta, në mënyrë që ti shmangët “etiketimeve” të ndryshme të cilat kanë një çmim të lartë emocional dhe social për të. Në moshën e rritur problemet më të dukshme kanë të bëjnë me kujtesën verbale afatshkurtër, me kujtesën e punës dhe automatizimin e leximit (Nergard- Nilssen, 2014). Studentët disleksikë mund të kenë vështirësi të shprehen përpara audiencës, mund të shfaqen mosbesues në aftësitë e veta dhe shpeshherë të stepen, por janë pjesëmarrës aktiv të leksioneve dhe veprimtarive universitare (Pino, 2014). Globalisht 1 në 25 njerëz është disleksik deri në një masë, ndërsa 2% e popullsisë vuan nga një disleksi e rëndë.

Disgrafia (vështirësia në të shkruar)

Të shkruarit është një proces i mësuar, i qëllimshëm dhe i vetëdijshëm që iu drejtohet të tjerëve për t’ju komunikuar diçka. Gjatë të shkruarit marrin pjesë shumë procese kognitive si: organizimi, planifikimi, memorizimi, marrja e vendimeve verbale, kordinimi i të gjithave përbën kompleksitetin e të shkruarit, ndërsa moskordinimi i tyre na shfaqë vështirësinë në të shkruar (Garuli, 2018). Digrafia është një vështirësi në të mësuar që ndikon në aftësinë e të shkruarit, aftësitë e shkëlqyera motorike dhe aftësitë e përpunimit të informacionit. Kjo vështirësi e veçantë mund të shfaqet në mënyra të ndryshme tek njerëzit e të gjitha moshave. Në të gjitha rastet e disgrafisë, shkrimi merr sasi të madhe energjie dhe përqëndrimi (Brant, 2014).

Disgrafia është lloji i dytë i çrregullimeve të të nxënës. Ka të bëjë jo me dallime në kuptimin dhe përmbajtjen e fjalës, por me vështirësi dhe problematika të lidhura me formën e të shkruarit, drejtimit dhe rregullit. Në rastin e disgrafisë është i prekur aspekti motor i shkrimit, ai që është përgjegjës për kryerjen e lëvizjeve gjatë procesit të të shkruarit. Vështirësitë e të shkruarit janë dy llojesh: disortografia, që prekë përmbajtjen e shkrimit dhe disgrafia që prekë formën e tij (Garuli, 2018). Sa i përket moshës se kur mund të bëhet vlerësimi lidhur me vështirësitë e të shkruarit, më e përshtatshme konsiderohet të jetë përfundimi i klasës së parë ose

edhe klasa e dytë. Nuk bëhet fjalë që në këtë moshë të bëhet vlerësimi i plotë, mirëpo ajo çka mund të vërehet qartë është nëse fëmija ka prirje për të zhvilluar problematika të mëvonshme në të shkruar, pra nëse ka elemente të keqfunksionimit të formës së të shkruarit, pra disgrafi apo mund të shfaq dëmtime në aftësinë për të riprodhuar fjalën e shkruar pra ortografi (Vio, 2021). Në një studim të kryer me 259 fëmijë të moshës 13-14 vjeçare është konstatuar se nëse fëmija ka vështirësi në të nxënë si p.sh disgrafi atëherë ka dëmtime edhe në funksione të tjera neurologjike (Gubbay, 1995). Ndërsa në një studim tjetër të kryer me 66 fëmijë të cilët ishin shtruar në repartin e pediatriisë neurologjike përshkak se nuk mund të arrinin suksesin e duhur në shkollë, iu nënshtruan testeve më të detajuara neurologjike duke përfshirë kështu edhe një vlerësim të plotë të funksionimit të dorës. Është konstatuar se fëmijët disgrafikë nuk arrinin të kryenin funksionin e kapjes së objekteve me dorë ashtu sikurse fëmijët me zhvillim normal dhe se 30% e tyre i takonin gjinisë mashkullore (O'Hare, 1989). Një studim tjetër na thotë se fëmijët me disgrafi zakonisht kanë disa kombinime vështirësish që kanë të bëjnë me sistemin motor të trurit, funksion të dobët të rivizualizimit të shkronjave, dhe paaftësi për të mbajtur mend formën e tyre (Deuel, 1994). Disgrafia si vështirësi është shumë më pak e studiuar se sa disleksia zhvillimore, pasi që thuhet se ka një lidhje të lartë midis leximit të fjalëve dhe shkrimit të tyre, të dyja aftësitë kanë shumë të përbashkëta gjatë procesit të pëvetësimit të ndonjëres prej tyre, pasi që sistemi alfabetik ka rol kyç tek secila. Shumë fakte na çojnë se aftësitë të cilat nevoiten për lexim janë të ngjajshme me ato të shkrimit edhe pse parashihet që shkrimi të jetë më kërkues (Döhla, 2016). Ajo çka tashmë dihet është se disgrafia lidhet me çrregullime neurologjike, mirëpo përgjatë një studimi të kryer me fëmijë që kishin inteligjencë normale por të kombinuar me ADHD dhe fëmijët me spektër të autizmit është konstatuar se, më shumë se gjysma kishin disgrafi dhe 92% prej tyre shfaqnin aftësi të dobëta motorike në kahasim me aftësitë e tjera (Mayes, Breaux, & Calhoun, 2019).

Disgrafia e bën procesin e shkrimit të vështirë dhe produkti shpesh është i paqartë, shpeshherë shkronjat janë ose shumë të mëdha ose shumë të vogëla, forma e tyre është më e thjeshtëzuar, hapësira është shumë e madhe ose shkrimi është tejet i ngjeshur, ndonjëherë shtypin lapsin shumë ose shkruajnë shumë lehtë gjë që e bën shkrimin e tyre të palexueshëm. Ndodh që kjo ndryshon kur fëmija rritet ose mund të ketë pasoja që shtrihen deri në moshë madhore, që i le ata prapa me shkrim ose me aftësi të tjera të motorikës fine. Jo vetëm fëmijët që kanë këtë vështirësi në të shkruar hargjojnë shumë energji, por edhe shkruarit tipikë duhet të kenë disa

aftësi funksionuese si: organizim, vëmendje te detajet dhe përkushtim të vazhdueshëm (Franklin, 2018).

Diskalkulia (vështirësia në matematikë)

Krijimi i sensit mbi numrat ka të bëjë me aftësinë për ti njohur e për të operuar me to. Konsiderohet se kjo kompetencë është e lindur dhe e pranishme tek shumë specie kafshësh, të cilat kanë aftësi numerike pa i mësuar apo ushtruar (Agrilo, 2012).

Ndryshe nga shkrimi dhe leximi të cilat konsiderohen si “shpikje” shoqërore e kulturore dhe bazohen mbi edukimin dhe të mësuarit, numërimi dhe veprimet me to kanë baza të caktuara neuronale dhe janë rrjedhojë e evolucionit (Stoianov, 2012).

Sipas Pizhesë fëmija fillon të numërojë pa e pasur të kristalizuar në mënyrë të mirëfilltë nocionin numër, në fillim fëmija i lidh numrat me objektet duke ditur se objektit i korresponon fjala “një” kurse dy objekteve i korresponon fjala “dy”. Nga kjo kuptojmë se inteligjenca matematikore i paraprinë asaj gjuhësore dhe në fillim të numërimit të tij, fëmija nuk bën asgjë tjetër veçse riprodhon atë që dëgjon nga të rriturit. Koncepte të qëndrueshme mbi numrat dhe veprimet mbi to fëmija nuk i formon deri në moshë 5-6 vjeçare. Pra njeriu lind me predispozita për të mësuar matematikën, por ndodh që mund të dëmtohen aftësitë matematikore dhe të lind paraqitja e diskalkulisë apo vështirësisë në matematikë. Gjatë një eksperimenti të kryer tek fëmijët e moshës 6-8 muaj Starkey së bashku me autorë të tjerë evidentuan praninë e shprehive të diferencimit të objekteve të ndryshme në bazë të sasisë dhe sipas numrave të paraqitur. Fëmijët vëzhgonin më gjatë dhe u kushtonin më shumë vëmendje kur i paraqiteshin imazhe me përmbajtje objektiv të ndryshme nga ajo e fillimit, jo vetëm me rend rritës (nga 2 në 4), por edhe me rend zbritës (nga 4 në 2). Normalisht këtu është menduar se fëmijë u kushtonin më shumë rëndësi imazheve, kur janë të ndryshme sepse është e natyrshme të tërhiqen nga një stimul i ri (Starkey, 1990). Për ti dhënë përgjigje këtij dyshimi janë bërë edhe studime të tjera me të njëjtin fokus, njëri prej tyre është edhe ai i Wyn-it i cili analizoi reagimet e fëmijëve kur stimujt e prezantuar nuk ishin më të ndryshëm vetëm në aspektin sasior, por imazhet ndryshonin njëri nga tjetri në lëvizje. Fëmijëve iu prezantuan forma të ndryshme gjeometrike që lëviznin në ekran në mënyrë rastësore dhe të çrregullt. Trajektoret që ata përshkonin e bënë të pamundur identifikimin e formave, pra në këtë aspekt nuk iu tërhiqej vëmendja. Por ajo që u vu re është se

kur shtohet numri i figurave gjeometrike fëmijët tregojn interes ndaj asaj që shihnin (Wyn, 1995).

Mosha më e përshtatshme për të identifikuar diskalkulinë është fundi i klasës së tretë fillore, poashtu gjatë kësaj kohe është e rëndësishme të ekzaminohen edhe kompetencat vizuale-hapësinore bashkë me kujtesën pasi të gjitha këto luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e të mësuarit matematikor (Passolunghi, 2012).

Diskalkulia është ai çrregullim specifik i të nxënësve i cili lidhet me shfaqjen e vështirësive në aftësitë matematikore, me njohjen dhe përdorimin e aftësive matematikore, kryerjen e veprimeve aritmetike, identifikimin dhe të kuptuarit e shumave numerike. Këto aftësi janë të dëmtuara në rastin e diskalkulisë, që do të thotë se këta fëmijë paraqesin performancë të ulët në matematikë dhe ndeshin shumë pengesa në këtë lëndë gjatë ecurisë së tyre shkollore. Kanë vështirësi në mbajtjen mend edhe të procedurave shumë të thjeshta matematikore dhe kujtesë pune shumë të varfër kur arsyetojnë mbi numrat. E kanë shumë të vështirë të bëjnë përparime në matematikë duke qenë se logjika e tyre matematikore është në nivele bazike fillestare. Edhe kur arrijnë disa përmisime në kohë të shkurtër, e kanë shumë të vështirë ti konsolidojnë ato ndryshime dhe të vazhdojnë progresin, por harrojnë atë që kanë mësuar (Garuli, 2018).

Llojet e diskalkulisë janë tri:

- a) Disleksia leksike ose ndryshe disleksia e shifrave. Karakterizohet nga deficietet gjuhësore të matematikës, vështirësi të shumta për të lexuar numrat në mënyrën e duhur p.sh numri 2 lexohet 9, ose numri 52 lexohet 56.
- b) Diskalkulia procedurale. Paaftësia për të ndjekur rradhën dhe logjikën e veprimeve matematikore.
- c) Diskalkulia aritmetike. Paaftësi për të kryer përmendësh edhe veprimet shumë të thjeshta matematikore, p.sh. $10+30$: $40/2$: 50×2 (Erickson, 2017).

Ekzistojnë evidenca që diskalkulia ka baza gjenetike. Rezultatet e një studimi që analizoi të dhënat nga familjet me fëmijë me vështirësi në matematikë treguan se vëllezërit dhe motrat e fëmijëve me këtë çrregullim, kanë 5-10 herë më shumë gjasa të jenë të prekur nga diskalkulia, sesa mesatarja e popullsisë (Alarcon, Defries, Gillis Light, & Pennington, 1997).

Diskalkulia është e lidhur edhe me vështirësi të tjera, në një studim me nxënës diskalkulikë nga klasa e tretë deri në të pestën, u zbulua se ekziston bashkëshoqërimi me vështirësinë e disleksisë në një masë prej 12%; ndërkohë që nëse këtyre diagnozave i shtohet edhe çrregullimi i vëmendjes dhe hiperaktiviteti, kjo përqindje rritet me 27%. Sipas autorëve fëmijët e diagnostifikuar me çrregullim të vëmendjes, sidomos ata të nëntipit të kombinuar, shfaqin performancë më të ulët akademike në matematikë sesa në lëndë tjera (Mayes & Calhoun, 2006). Pra vëmendja luan një rol të rëndësishëm në kryerjen e veprimeve aritmetike.

Evidencat tregojnë se nxënësit diskalkulikë mund të jenë të suksesshëm nëse identifikimi bëhet në kohën e duhur dhe ndërhyrja të jetë sa më e hershme, mirëpo e rëndësishme është që ndërhyrja të jetë afatgjate sepse ajo afatshkurte sado intenzive të jetë nuk do të ketë suksesin e duhur (Butterworth, 2011).

Dispraksia (vështirësia në lëvizje)

Në bazë të rezultateve të hulumtimit kuptojmë se nxënësit kanë vështirësi në organizimin e aktiviteteve shkollore, e gjithashtu mund të themi se ekziston një shpërqendrim i lehtë nga ndikimet e jashtme. Shqetësuese është edhe fakti se ata i harrojnë shpejtë aktivitetet e përditshme/rutinore dhe se kanë një nivel të konsiderueshëm të ngathtësisë. Mësimdhënësit shprehen se nxënësit nuk kanë sukses me lojëra dhe aktivitete që kërkojnë koordinimin e syve me duar, apo edhe kanë probleme me shtypjen e butonave, në kryerjen e aktiviteteve të

ndryshme me grepa, kapëse, zinxhirë dhe nuk arrijnë të bëjnë lidhjen e këpucëve, aktivitete këto që na bëjnë me dije koordinimin jo të drejtë të lëvizjeve. Por vështirësitë nuk ndalojnë këtu, ata gjithashtu nuk arrijnë ta mbajnë lapsin në formën e duhur, duke rezultuar kështu me shkrim të dobët, kanë vështirësi edhe në përdorimin e objekteve të vogla apo gjësendeve që kërkojnë saktësi, poashtu demonstrojnë vonesa në të folur dhe kanë vështirësi të ritregojnë atë që sapo është thënë. Niveli i përqindjeve në disa raste është jo shumë i lartë, por afërsisht mbi 30-40% paraqesin nivele të tilla të problemeve gjë që është shumë domethënëse për shoqërinë dhe për zhvillimin e mëtutjeshëm të fëmijëve, andaj duhet kushtuar shumë kujdes dhe dhe tu ofrojmë qasje më profesionale.

Tabela 50. Analiza mbi shfaqjen e dispraksisë tek nxënësit.

	Pajtohem plotësisht		Pajtohem pjesërisht		Mesatarisht		Nuk pajtohem pjesërisht		Nuk pajtohem aspak	
	N	%	N	%	N	%	N	%	N	%
	Ka vështirësi në organizimin e aktiviteteve	26	13.0%	56	28.0%	56	28.0%	37	18.5%	25
Shpërqendrohet lehtë nga ndikimet e jashtme.	33	16.5%	54	27.0%	57	28.5%	36	18.0%	20	10.0%
I harron shpejtë aktivitetet e përditshme/rutinore.	25	12.5%	47	23.5%	63	31.5%	38	19.0%	27	13.5%
Është i ngathët, derdh dhe rrëzon gjëra nga duart.	23	11.5%	29	14.5%	57	28.5%	49	24.5%	42	21.0%
Nuk ka sukses me lojëra dhe aktivitete që kërkojnë koordinimin e syve me duart (p.sh., mësimet pianoje, basketbolli, bejsbolli).	14	7.0%	39	19.5%	47	23.5%	54	27.0%	46	23.0%
Ka probleme me shtypje të butonave, në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme me grepa, kapëse, zinxhirë dhe nuk arrijnë të bëjnë lidhjen e këpucëve.	19	9.5%	29	14.5%	53	26.5%	48	24.0%	51	25.5%

Mban lapsin në mënyrë jo të duhur, duke rezultuar në shkrim të dobët.	24	12.0%	45	22.5%	32	16.0%	49	24.5%	50	25.0%
Ka vështirësi në përdorimin e objekteve të vogla ose sendeve që kërkojnë saktësi (p.sh., lego, puzzle, pincetë, gërshërë).	26	13.0%	34	17.0%	55	27.5%	42	21.0%	43	21.5%
Demonstron vonesa në të folur.	24	12.0%	42	21.0%	59	29.5%	31	15.5%	44	22.0%
Ka vështirësi të ritregojë atë që sapo është thënë.	28	14.0%	44	22.0%	52	26.0%	36	18.0%	40	20.0%




Figura 7. Analiza mbi shfaqjen e dispraksisë.

Sipas opinionit të mësimdhënësve paraqiten shumë nivele të larta të vështirësive të nxënësve edhe në aspektin e demonstrimit të folurit të ngadaltë dhe të ndërprerë, duke përdorur shtesa, si dhe ngatërrim të fjalëve të cilat tingëllojnë ngjashëm me të tjerat. Ka raste jo të vogla të atyre që kanë interes të kufizuar për libra ose tregime. Afërsisht mbi 30% kanë vështirësi për të kuptuar udhëzimet e detyrave dhe njohjen e kuptimin e fjalëve të reja. Një përqindje e lartë e nxënësve shpesh humbin vendin gjatë leximit, e gjithashtu ndryshojnë rendin e shkronjave në fjalë, duke pasur probleme edhe në emërtimin e shkronjave. Mësimdhënësit shprehen se një numër i nxënësve nuk iu pëlqen të lexojnë, demonstrojnë vonesa në të mësuarit për të kopjuar dhe shkruar tekste të ndryshme, si dhe kanë vështirësi në kujtimin se si duken shkronjat dhe numrat. Ka raste kur i përmbysin shkronjat, numrat dhe simbolet, apo edhe kopjojnë nga tabela në mënyra të pasakta. Përveç kësaj, ata gjithashtu manifestojnë në një nivel jo të lartë edhe vështirësi të shoqërimit me moshatarët.

Tabela 51. Analiza mbi shfaqjen e disleksisë tek nxënësit.

	Pajtohem plotësisht		Pajtohem pjesërisht		Mesatarisht		Nuk pajtohem pjesërisht		Nuk pajtohem aspak	
	N	%	N	%	N	%	N	%	N	%
Demonstron të folur të ngadaltë dhe të ndërprerë, duke përdorur shumë shtesa (p.sh., uh, um, dhe, e dini, kështu).	33	16.5%	40	20.0%	53	26.5%	38	19.0%	36	18.0%
Ngatërron fjalët që tingëllojnë të ngjashme me të tjerat.	28	14.0%	49	24.5%	59	29.5%	35	17.5%	29	14.5%
Ka interes të kufizuar për libra ose tregime.	25	12.5%	55	27.5%	52	26.0%	40	20.0%	28	14.0%
Ka vështirësi për të kuptuar udhëzimet e detyrave.	32	16.0%	45	22.5%	66	33.0%	33	16.5%	24	12.0%

Ka vështirësi në njohjen dhe kuptimin e fjalëve të reja.	32	16.0%	55	27.5%	54	27.0%	37	18.5%	22	11.0%
Shpesh humbet vendin gjatë leximit.	29	14.5%	39	19.5%	59	29.5%	47	23.5%	26	13.0%
Ndryshon rendin e shkronjave në fjalë, p.sh (jep-pej).	26	13.0%	48	24.0%	51	25.5%	44	22.0%	31	15.5%
Ka probleme në emërtimin e shkronjave.	35	17.5%	35	17.5%	51	25.5%	45	22.5%	34	17.0%
Zëvendëson ose shmang disa fjalë gjatë leximit.	28	14.0%	49	24.5%	48	24.0%	37	18.5%	38	19.0%
Nuk i pëlqen të lexojë.	28	14.0%	33	16.5%	52	26.0%	52	26.0%	35	17.5%
Demonstron vonesa në të mësuarit për të kopjuar dhe shkruar tekste të ndryshme.	25	12.5%	42	21.0%	49	24.5%	49	24.5%	35	17.5%
Ka vështirësi të kujtojë si duken shkronjat dhe numrat.	27	13.5%	31	15.5%	56	28.0%	46	23.0%	39	19.5%
Shpesh i përmbysë shkronjat, numrat dhe simbolet.	25	12.5%	33	16.5%	61	30.5%	35	17.5%	46	23.0%
Kopjon nga tabela në mënyrë të pasaktë (p.sh., ngatërron shkronja dhe numra me pamje të ngjashme).	31	15.5%	41	20.5%	51	25.5%	42	21.0%	35	17.5%
Ka vështirësi të shoqërohet me moshatarët.	17	8.5%	41	20.5%	48	24.0%	48	24.0%	46	23.0%




Figura 8. Analiza mbi shfaqjen e disleksisë.

Sipas mësimdhënësve ka një numër të madh të nxënësve të cilët nuk reagojnë si duhet ndaj ngacmimeve që u ndodhin, por edhe kanë vështirësi në vetëkontrollim kur janë të zhgënjyer. Një numër i konsiderueshëm kanë vështirësi në shfaqjen e njohurive mbi numrat por edhe kanë një qasje të dobët mbi renditjen e numrave duke rezultuar në gabime llogaritëse. Ka raste kur kanë vështirësi me krahasimet, por edhe mbi konceptin e kalimit të kohës dhe të numërimit të shpejtë ose llogaritjeve. Ata shprehen gjithashtu se një numër i madh i nxënësve kanë probleme në të mësuarit e tabelave, formulave dhe rregullave të shumëzimit. Sa i përket anës profesionale të mësuesve ata pohojnë se nxënësit identifikohen lehtë me vështirësi në të nxënë, poashtu një përqindje e lartë sipas tyre kanë vështirësi që mund të konsiderohen të lindura, mirëpo angazhimi i tyre në këtë aspekt ulë intensitetin e këtyre vështirësive.

Në anën tjetër, mësimdhënësit konsiderojnë se pjesa më e madhe e nxënësve shfaqin vështirësi në lexim dhe shkrim, duke mos lënë prapa edhe vështirësitë me matematikën dhe me maipulimin e motorikës fine, dhe më i rëndësishmi dhe më brengosësi është fakti se mbi 50% e mësimdhënësve pohojnë se në shkollat e tyre janë shumë të përhapura vështirësitë në të nxënë, dukuri kjo e cila dëmton intelektin dhe arritjet e fëmijëve.

Tabela 52. Analiza mbi përhapjen e vështirësive në të nxënë në shkollat fillore.

	Pajtohem plotësisht		Pajtohem pjesërisht		Mesatarisht		Nuk pajtohem pjesërisht		Nuk pajtohem aspak	
	N	%	N	%	N	%	N	%	N	%
	Nuk reagon si duhet ndaj ngacmimeve.	24	12.0%	35	17.5%	51	25.5%	47	23.5%	43
Ka vështirësi me vetëkontrollin kur zhgënjehet.	22	11.0%	40	20.0%	67	33.5%	39	19.5%	32	16.0%
Shfaq vështirësi në njohuritë mbi numrat (p.sh. njohja e madhësive pa numëruar).	29	14.5%	36	18.0%	67	33.5%	35	17.5%	33	16.5%

Ka vështirësi për të mësuar dhe memorizuar faktet themelore të mbledhjes dhe zbritjes.	30	15.0%	40	20.0%	58	29.0%	49	24.5%	23	11.5%
Rendit dobët numrat duke rezultuar në gabime llogaritëse.	32	16.0%	36	18.0%	62	31.0%	42	21.0%	28	14.0%
Ka vështirësi me krahasimet (p.sh., më pak se, më e madhe se).	33	16.5%	32	16.0%	58	29.0%	25.5%	26	13.0%	
Ka vështirësi mbi konceptin e kalimit të kohës.	32	16.0%	27	13.5%	59	29.5%	47	23.5%	35	17.5%
Ka vështirësi të numërojë shpejt ose të bëjë llogaritjet.	29	14.5%	33	16.5%	59	29.5%	56	28.0%	23	11.5%
Ka probleme në të mësuarit e tabelave, formulave dhe rregullave të shumëzimit.	35	17.5%	36	18.0%	66	33.0%	38	19.0%	25	12.5%
Nxënësit identifikohen lehtë me vështirësi në të nxënë.	37	18.5%	47	23.5%	50	25.0%	48	24.0%	18	9.0%
Vështirësitë në të nxënë janë të lindura.	42	21.0%	41	20.5%	66	33.0%	30	15.0%	21	10.5%
Angazhimi i mësimdhënësve zbut vështirësitë në të nxënë tek nxënësit.	64	32.0%	35	17.5%	48	24.0%	38	19.0%	15	7.5%
Nxënësit shfaqin më shumë vështirësi në lexim.	40	20.0%	30	15.0%	63	31.5%	44	22.0%	23	11.5%
Nxënësit shfaqin më shumë vështirësi në shkrim.	37	18.5%	39	19.5%	55	27.5%	49	24.5%	20	10.0%
Nxënësit shfaqin më shumë vështirësi në matematikë.	34	17.0%	35	17.5%	76	38.0%	37	18.5%	18	9.0%
Nxënësit shfaqin më shumë vështirësi në manipulimin e motorikës fine.	45	22.5%	45	22.5%	51	25.5%	44	22.0%	15	7.5%
Mendoj se në shkollat tona janë të përhapura mjaftë vështirësitë në të nxënë.	62	31.0%	51	25.5%	45	22.5%	32	16.0%	10	5.0%




Figura 9. Analiza mbi prevalencën e vështirësive në të nxënë.

Vërtetimi i hipotezave

Testimi i hipotezës së parë

Për të vërtetuar hipotezën e parë e cila thotë: “Vështirësitë në të nxënë janë të përhapura në masë të madhe tek nxënësit e ciklit fillor”, është aplikuar testi Hi^2 , ku variabla e pavarur është gjinia e mësimdhënësve, ndërsa variabla e varur është deklarata: “Mendoj se në shkollat tona janë të përhapura mjaftë vështirësitë në të nxënë”. Sipas rezultateve të mëposhtme shohim se shumica e mësimdhënësve pajtohen plotësisht për një dukuri të tillë në shkolla, rezultat ky që vërteton hipotezën e hulumtimit.

Tabela 53. Testit Hi^2 për hipotezën e parë.

Gjinia: * Mendoj se në shkollat tona janë të përhapura mjaftë vështirësitë në të nxënë.

Crosstabulation

Count

	Mendoj se në shkollat tona janë të përhapura mjaftë vështirësitë në të nxënë.					Total
	Pajtohem plotësisht	Pajtohem pjesërisht	Mesatarisht	Nuk pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem aspak	
Gjinia: Femër	42	36	30	22	5	135
Mashkull	20	15	15	10	5	65
Total	62	51	45	32	10	200




Figura 10. Testi Hi^2 për hipotezën e parë.

Nga rezultatet e paraqitura në tabelën 54 shohim se Pearson Chi-Square është 1.656, shkalla e lirisë është 4, ndërsa p-value është 0.799, gjë që dëshmon se nuk ka dallime signifikante në mes të opinionit të mësimdhënësve dhe se shumica dërmuese mendojnë se vështërsitë në të nxënë janë të përhapura në masë të madhe tek nxënësit e ciklit fillor.

Tabela 54. Testi Pearson Chi-Square.

Chi-Square Tests

	Value	Df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	1.656 ^a	4	0.799
Likelihood Ratio	1.571	4	0.814
Linear-by-Linear Association	0.380	1	0.538
N of Valid Cases	200		

a. 1 cells (10.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 3.25.

Testimi i hipotezës së dytë

Për vërtetimin e hipotezës së dytë: “*Mësimdhënësit nuk kanë përgatitje të mjaftueshme profesionale për trajtimin e duhur të këtyre vështirësive*” është përdorur testi i korrelacionit, ku variabla e pavarur është kualifikimi i mësimdhënësve, ndërsa ajo e varur është mesatarja e pyetjeve (Pyetja 37, Pyetja 38, Pyetja 39, Pyetja 41, Pyetja 42) të cilat paraqesin mesataren e vështirësive në të nxënë.

Tabela 55. Testi i korrelacionit për hipotezën e dytë.

Correlations

		Vështirësitë në të	
		Niveli i shkollimit	nxënë
Niveli i shkollimit	Pearson Correlation	1	0.058
	Sig. (2-tailed)		0.417
	N		200
Vështirësitë në të nxënë	Pearson Correlation		1
	Sig. (2-tailed)		
	N		




Figura 11. Testi i korrelacionit për hipotezën e dytë.

Rezultatet e mësipërme tregojnë se nuk është gjetur korrelacion në mes të kualifikimit të mësimdhënësve dhe vështirësive në të nxënë ($r=0.058$, $p\text{-value}=0.417$) e cila është më e lartë se 0.05 e margjinës së gabimit. Me këtë hedhim poshtë hipotezën se mësimdhënësit nuk kanë përgatitje të mjaftueshme profesionale për trajtimin e duhur të këtyre vështirësive, pasi që deklaratat e tyre e kanë vërtetuar të kundërtën.

Testimi i hipotezës së tretë

Në këtë rast kemi pyetjen kërkimore: *Cilat prej vështirësive në të nxënë janë më shpesh të shfaqura tek nxënësit?* që i përkon hipoteza e tretë

H3 - Disleksia dhe disgrafia janë vështirësitë më të përhapura tek nxënësit.

Për të testuar se cila nga këto vështirësi është më shpesh e shfaqur tek nxënësit e ciklit fillor, është aplikuar testi KMO dhe Bartlett testi për të testuar margjinën e gabimit. Pastaj kemi aplikuar klasifikimin e ndryshoreve, ku rezultatet treguan se janë 6 kategori të vështirësive në të nxënë.

Siç mund të shohim nga tabela 56, testi KMO dhe Bartlett testi vërtetojnë se të dhënat janë të pranueshme, ku $KMO=0.944$, $\chi^2=6.210.962$, me shkallë të lirisë = 666, si dhe $p\text{-value}=0.000$ e cila është signifikante në 0.01 të margjinës së gabimit.

Tabela 56. Testi KMO për hipotezën e tretë.

KMO and Bartlett's Test

Kaiser-Meyer-Olkin	Measure of Sampling Adequacy.	0.944
Bartlett's Test of Sphericity	Approx. Chi-Square Df	6,210.962
	Sig.	0.000

Në bazë të tabelës 57, shohim se ndryshoret janë klasifikuar në 6 kategori që tregojnë se kemi më shumë se dy faktorë që janë të përhapur tek nxënësit si vështirësi në të nxënë.

Tabela 57. Klasifikimi i ndryshoreve

Total Variance Explained

Component	Initial Eigenvalues			Extraction Sums of Squared Loadings			Rotation Sums of Squared Loadings		
	Total	% of Variance	Cumulative %	Total	% of Variance	Cumulative %	Total	% of Variance	Cumulative %
1	18.644	50.388	50.388	18.644	50.388	50.388	6.822	18.437	18.437
2	2.187	5.912	56.301	2.187	5.912	56.301	5.460	14.756	33.192
3	1.634	4.416	60.716	1.634	4.416	60.716	5.295	14.310	47.503
4	1.333	3.602	64.318	1.333	3.602	64.318	3.201	8.652	56.155
5	1.279	3.456	67.774	1.279	3.456	67.774	2.823	7.630	63.785
6	1.006	2.720	70.494	1.006	2.720	70.494	2.482	6.709	70.494
7	0.938	2.535	73.029						
8	0.775	2.094	75.123						
9	0.685	1.851	76.973						
10	0.617	1.669	78.642						
11	0.587	1.586	80.228						
12	0.563	1.522	81.750						
13	0.524	1.416	83.166						
14	0.520	1.405	84.570						
15	0.485	1.310	85.880						
16	0.424	1.145	87.025						
17	0.413	1.116	88.141						
18	0.393	1.061	89.203						
19	0.358	0.967	90.170						
20	0.352	0.951	91.121						
21	0.326	0.881	92.002						

22	0.287	0.776	92.778
23	0.273	0.738	93.515
24	0.263	0.711	94.226
25	0.245	0.663	94.889
26	0.228	0.617	95.506
27	0.218	0.588	96.094
28	0.201	0.542	96.637
29	0.186	0.503	97.139
30	0.184	0.497	97.636
31	0.154	0.417	98.053
32	0.144	0.390	98.443
33	0.137	0.371	98.813
34	0.130	0.352	99.165
35	0.126	0.341	99.506
36	0.104	0.280	99.786
37	0.079	0.214	100.000

Extraction Method: Principal Component Analysis.




Figura 12. Lakorja e ndryshoreve.

Kjo figurë tregon rënien nga ndryshorja 6 e cila vërteton se do të kemi 6 faktorë.

Në kategorinë e parë hyjnë ndryshoret: ka probleme në emërtimin e shkronjave (0.727), ka vështirësi të kujtojë si duken shkronjat dhe numrat (0.766) dhe shpesh i përmbysë shkronjat, numrat dhe simbolet (0.741), gjë që mund të shkoj drejt disleksisë.

Në kategorinë e dytë hyjnë ndryshoret: shfaq vështirësi në njohuritë mbi numrat (p.sh. njohja e madhësive pa numëruar (0.654), dhe ka vështirësi me krahasimet (p.sh., më pak se, më e madhe se) (0.776), e cila na bën me dije praninë e diskalkulisë.

Në kategorinë e tretë hyjnë ndryshoret: nuk ka sukses me lojëra dhe aktivitete që kërkojnë koordinimin e syve me duart (p.sh., mësimet pianoje, basketbolli, bejsbolli) (0.727), ka probleme me shtypje të butonave, në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme me grepa, kapëse, zinxhirë dhe nuk arrin të bëjë lidhjen e këpucëve (0.803), mban lapsin në mënyrë jo të duhur, duke rezultuar në shkrim të dobët (0.770) dhe ka vështirësi në përdorimin e objekteve të vogla

ose sendeve që kërkojnë saktësi (p.sh., lego, puzzle, pincetë, gërshërë) (0.697), e cila emërohet ndryshe si vështirësia në aktivitete që kanë të bëjnë me motorikën fine.

Në kategorinë e katërt janë ndryshoret: nxënësit identifikohen lehtë me vështirësi në të nxënë (0.718), vështirësitë në të nxënë janë të lindura (0.749) dhe angazhimi i mësimdhënësve zbut vështirësitë në të nxënë tek nxënësit (0.707) e cila tregon profesionalizmin e mësimdhënësve në këtë rast si dhe njohuritë që kanë ata sa i përket këtyre vështirësive.

Në kategorinë e pestë janë ndryshoret si: ka interes të kufizuar për libra ose tregime (0.617) dhe ka vështirësi për të kuptuar udhëzimet e detyrave (0.675), e cila tregon çrregullim në të kuptuarit e gjërave.

Në kategorinë e gjashtë janë ndryshoret: ka vështirësi në organizimin e aktiviteteve (0.711) dhe shpërqendrohet lehtë nga ndikimet e jashtme (0.833), e cila mund të emërohet si çrregullim i vëmendjes.

Në këtë rast themi se krahas disleksisë dhe disgrafisë, ka edhe faktorë të tjerë të cilët paraqiten si vështirësi siç janë: vështirësia në veprime të ndryshme matematikore, ajo e manipulimit të lëvizjeve, duke mos lënë anash kështu edhe vështirësitë emocionale dhe çrregulimet e vëmendjes, të gjetura këto që nuk kanë qenë objekt studimi, por gjatë analizave kanë dalë në pah.

Tabela 58. Kategoritë e ndryshoreve.

Rotated Component Matrix^a

	Component					
	1	2	3	4	5	6
Ka vështirësi në organizimin e aktiviteteve						0.711
Shpërqendrohet lehtë nga ndikimet e jashtme.						0.833

I harron shpejtë aktivitetet e përditshme/rutinore.

Është i ngathët, derdh dhe rrëzon gjëra nga duart.

Nuk ka sukses me lojëra dhe aktivitete që kërkojnë koordinimin e syve me duart (p.sh., mësimet pianoje, basketbolli, bejsbolli).

0.727

Ka probleme me shtypje të butonave, në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme me grepa, kapëse, zinxhirë dhe nuk arrin të bëjë lidhjen e këpucëve.

0.803

Mban lapsin në mënyrë jo të duhur, duke rezultuar në shkrim të dobët.

0.770

Ka vështirësi në përdorimin e objekteve të vogla ose sendeve që kërkojnë saktësi (p.sh., lego, puzzle, pincetë, gërshërë).

0.697

Demonstron vonesa në të folur.

Ka vështirësi të ritregojë atë që sapo është thënë.

Demonstron të folur të ngadaltë dhe të ndërprerë, duke përdorur shumë shtesa (p.sh., uh, um, dhe, e dini, kështu).

Ngatërron fjalët që tingëllojnë të ngjashme me të tjerat.

Ka interes të kufizuar për libra ose tregime.

0.617

Ka vështirësi për të kuptuar udhëzimet e detyrave.

0.675

Ka vështirësi në njohjen dhe kuptimin e fjalëve të reja.

Shpesh humbet vendin gjatë leximit.

Ndryshon rendin e shkronjave në fjalë, p.sh (jep-pej).

Ka probleme në emërtimin e shkronjave.

0.727

Zëvendëson ose shmang disa fjalë gjatë leximit.

Nuk i pëlqen të lexojë.

Demonstron vonesa në të mësuarit për të kopjuar dhe shkruar tekste të ndryshme.

Ka vështirësi të kujtojë si duken shkronjat dhe numrat.	0.766
Shpesh i përmbysë shkronjat, numrat dhe simbolet.	0.741
Kopjon nga tabela në mënyrë të pasaktë (p.sh., ngatërron shkronja dhe numra me pamje të ngjashme).	
Ka vështirësi të shoqërohet me moshatarët.	
Nuk reagon si duhet ndaj ngacmimeve.	
Ka vështirësi me vetëkontrollin kur zhgënjehet.	
Shfaq vështirësi në njohuritë mbi numrat (p.sh. njohja e madhësive pa numëruar).	0.654
Ka vështirësi për të mësuar dhe memorizuar faktet themelore të mbledhjes dhe zbritjes.	
Rendit dobët numrat duke rezultuar në gabime llogaritëse.	

Ka vështirësi me krahasimet (p.sh., më pak se, më e madhe se).	0.669
Ka vështirësi me krahasimet (p.sh., më pak se, më e madhe se).	0.776
Ka vështirësi të numërojë shpejt ose të bëjë llogaritjet.	
Ka probleme në të mësuarit e tabelave, formulave dhe rregullave të shumëzimit.	
Nxënësit identifikohen lehtë me vështirësi në të nxënë.	0.718
Vështirësitë në të nxënë janë të lindura.	0.749
Angazhimi i mësimit zbut vështirësitë në të nxënë tek nxënësit.	0.707

Extraction Method: Principal Component Analysis.

Rotation Method: Varimax with Kaiser Normalization.

a. Rotation converged in 8 iterations.

V. DISKUTIMI DHE KONKLUDIMET

Pjesa më e rëndësishme e hulumtimit është ky kapitull, i cili paraqet një përmbledhje të tërë punës. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të vihet në pah shtrirja që kanë marrë vështirësitë në të nxënë tek nxënësit e ciklit fillor, si dhe ndikimi që kanë vështirësitë e tilla në performancën akademike të tyre. Përveç kësaj, ky hulumtim në vete gërsheton edhe dy qëllime të tjera, njëri ka të bëjë mbi njohuritë e mësimdhënësve mbi këto vështirësi, kurse tjetri ka të bëjë me prevalencën e vështirësive në të nxënë. Rezultatet treguan se prevalenca e vështirësive në të nxënë tek nxënësit është goxha e lartë sipas opinionit të mësimdhënësve, gjithashtu këto vështirësi kanë një lidhje të ngushtë me performancën akademike të nxënësve, duke mos i lënë ata ta kapin ritmin së bashku me nxënësit tipik. Pra hipoteza e parë është vërtetuar duke i dhënë kështu kahje pozitive pyetjes kërkimore se, vështirësitë në të nxënë janë mjaftë prezente tek nxënësit. E gjetur tjetër e këtij hulumtimi është se, për dallim nga vitet e kaluara, mësimdhënësit kanë shpreh njohuri lidhur me këto vështirësi, dhe me ato çka dinë janë në gjendje ti ofrojnë fëmijëve një trajtim të mirëfilltë brenda klasës së tyre, e gjetur kjo që e hedh poshtë hipotezën e dytë, dhe i jep përgjigje pozitive pyetjes së dytë kërkimore të këtij punimi. Një rezultat tjetër i cili ka qenë gjithashtu objekt studimi është se, disleksia dhe disgrafia janë më evidente tek fëmijët, por edhe vështirësitë në matematikë dhe vështirësitë në manipulimin e lëvizjeve nuk lihen prapa, duke i shtuar kështu edhe çrregullimet emocionale dhe ato të vëmendjes. Pyetjes kërkimore mbi disleksinë dhe disgrafinë, si prej vështirësive më të përhapura, i gjejmë përgjigje pozitive, por ia shtojmë edhe praninë e diskalkulisë dhe dispraksisë. A mos ndoshta mësimdhënësit po i ngatërrojnë këto vështirësi, duke i menduar ato si të ngjajshme? Mbetet të shihet në të ardhmen nëse dikush e parashton prej kolegëve si çështje për hulumtim. Gjithashtu rekomandimet që do të dalin nga ky punim janë të rëndësishme për institucionet edukative-arsimore duke filluar prej atyre më të lartave e deri tek shkollat.

Hulumtimi është kryer në 15 shkolla të komunës së Prizrenit, 6 prej shkollave gjenden në zonat rurale të regjionit të Prizrenit, dhe 9 prej tyre gjenden në zonën urbane. Përzgjedhja e shkollave është bërë duke u bazuar nga numri më i madh i mësimdhënësve që punojnë, duke përmbushur kështu kërkesën e hulumtimit me 200 respondentë pjesëmarrës. Prej tyre 137 ishin që punonin në shkollat urbane dhe 63 në shkollat rurale.

Pjesa më e madhe e të anketuarve përfshinë gjininë femërore, gjegjësisht 135 prej tyre, pjesa e mbetur i takon gjinisë mashkullore gjegjësisht 65 prej tyre. Grupmoshat e tyre sillen prej 20 deri mbi 60 vjeç ku numri më madh i respondentëve i takon moshës 31 deri 40 vjeç. Sa i përket shkollimit dhe përvojës së punës, numri më i madh i mësimdhënësve ishin me shkollim bachelor, dhe shumica prej tyre kishin mbi 10 vite përvojë pune.

Në bazë të përgjigjeve të respondentëve kuptojmë se gjysma e më shumë prej tyre nuk e kanë të vështirë identifikimin e ndonjëres prej vështirësive në të nxënë, në rast se nxënësit shfaqin shenja të tyre, gjegjësisht 42% mendojnë se është i lehtë identifikimi i vështirësive, ndërsa 34% e tyre mendojnë të kundërtën.

Sa i përket asaj se angazhimi i mësimdhënësve zbutë intensitetin e vështirësisë që ka nxënësi, shumica e pjesënarrësve në anketim janë të pajtimit për një gjë të tillë, sidomos kur ndihma ju vjen qysh në fillimet e saj dhe nga profesionisti i duhur.

Kur marrim parasysh deklaratën: *“Mendoj se në shkollat tona janë mjaft të përhapura vështirësitë në të nxënë”*, përgjigjet e mësimdhënësve ishin: 56.5% e tyre *“Pajtohen”* me një pohim të tillë, 22.5% e mësimdhënësve janë *“Neutral”*, ndërsa 21% e tyre *“Nuk pajtohen”*. Duke u bazuar në përgjigjet e respondentëve në këtë deklaratë përfshirë këtu edhe pohimet e tjera sa i përket vështirësive në të nxënë, mund të konkludojmë se vështirësitë në të nxënë paraqesin një prevalencë të lartë në shkollat pjesëmarrëse në hulumtim. Prevalenca është pothuajse e njëjtë sa i përket të katër llojeve të vështirësive, e jo vetëm të njëres në veçanti.

Rezultatet e këtij hulumtimi janë në drejtim të njëjtë me disa prej hulumtimeve të shqyrtuara, ku sipas (Garuli, 2018) në Shqipëri ekziston një numër mjaftë i lartë i fëmijëve me vështirësi në të nxënë, të cilët përjetojnë në vete shumë presion nga ana e prindërve dhe shoqërisë, i cili ndikon në performancën akademike të tyre brenda klasës, dhe gjendja emocionale e tyre nuk është për t'u dëshiruar. Në anën tjetër edhe (Reid, 2006) gjeti se nxënësit me vështirësi në të nxënë që kanë marrë një intervenim të hershëm, kanë zbutur shenjat e asaj vështirësie dhe kanë arritur të kenë sukses në shkollë dhe në jetë.

Rezultati tjetër në të cilin mësimdhënësit shprehen se kanë njohuri mbi vështirësitë në të nxënë përkon me të gjeturat një hulumtimi ndërkombëtar të realizuar në SHBA nga (Pierangelo, 2010), i cili deklaroi se kohëve të fundit është bërë një vetëdijësim më i madh i popullatës lidhur

me këto “probleme”, pasi në ditët e sotme kemi mënyra të shumëta dhe të shpejta të marrjes së informacionit, kështu që e tërë kjo ka ndikuar që 2.7 milionë nxënës të marrin mbështetjen dhe trajtimin e duhur.

Gjithashtu edhe rezultatet e (Devolli, 2008) treguan se: “Në shkollat tona përkatësisht në kategorinë e nxënësve të moshës fillore, ekziston një numër i konsiderueshëm me vështirësi në lexim dhe shkrim”, rezultat i cili përkon me studimet paraprake duke i shtuar se edhe diskalkulia me dispraksinë kanë një prevalencë të konsiderueshme të shfaqjes tek nxënësit e ciklit fillor.

Gjatë një hulumtimi të kryer me fëmijë diskalkulikë nga (Mayes & Calhoun, 2006), është gjetur se 12% e fëmijëve të tillë shfaqin edhe shenja të disleksisë, dhe se këto vështirësi shumë lehtë kombinohen njëra me tjetrën. Gjithashtu edhe (Gubbay, 1995) gjatë një studimi konstatoi se nëse fëmija ka p.sh. disgrafi atëherë ai ka edhe dëmtime të funksioneve tjera neurologjike gjë që na shtynë të mendojmë se mos ndoshta edhe fëmijët për të cilët janë përgjigjur mësimdhënësit e përfshirë në këtë hulumtim kanë kombinim vështirësish? Kjo çështje mbetet e hapur për hulumtime në të ardhmen.

Niveli i përqindjeve është mjaftueshëm i lartë që evidenton nxënësit me të tilla vështirësi, e cila paraqet një situatë shqetësuese për shoqërinë e që duhet kushtuar shumë kujdes dhe një qasje profesionale. Gjë që edhe (Devolli, 2008) në punimin e saj të doktoratës ka konstatuar se roli i logopedit dhe profesionistit inkluziv është i një rëndësie të veçantë.

Një përqindje e lartë e mësimdhënësve shprehen se nxënësit me vështirësi në të nxënë kanë edhe vështirësi sociale, nuk shoqërohen me të tjerët dhe nuk kanë aftësi bashkëpunuese, fakt ky që vështirëson përparimin e tyre, gjithmonë duke u bazuar në atë se fëmijët më së miri mësojnë nga përvojat e njëri tjetrit.

Kufizimet e studimit

Kufizim i parë është mostra e hulumtimit e cila i takon vetëm një regjioni të caktuar dhe jo tërë vendit.

Një faktor që konsideroj se ka vështirësuar punën e këtij hulumtimi janë përgjigjet e mësimdhënësve të cilët kryesisht kishin zgjedhur përgjigjen neutrale në çdo deklaratë, kjo në njëfarë forme ka ndikuar në rezultatet e hulumtimit.

Gjendja emocionale e pjesëmarrësve në hulumtim si pasojë e stresit dhe situatave të ndryshme në punë, ka ndikuar në deklarinimin jo korrekt të tyre. Ky kufizim ka ndikuar negativisht në rezultate.

Hulumtimet në të ardhmen

Ky hulumtim ka një rëndësi të veçantë në fushën arsimore, për arsye se çështja e trajtuar këtu paraqet shqetësim për gjithë sistemin arsimor, duke marrë parasysh përhapjen në masë të madhe të këtyre vështirësive te nxënësit.

Në rast të përsëritjes së hulumtimit me të njejtin fokus sugjerojmë që:

- Hulumtimi të përfshijë më shumë respondentë nga regjione të ndryshme të vendit.
- Të masin cilësinë e përgaditjes së mësimdhënësve për trajtimin e mirëfilltë të nxënësve me vështirësi në të nxënë.

Në rast se realizohen hulumtime të reja në të njejtë fushë sugjerojmë që:

- Si mostër të jenë nxënësit me vështirësi në të nxënë, me qëllim që të kuptohet se a u plotësohen nevojat e tyre përgjatë procesit mësimor dhe në çfarë mënyre mësimdhënësit u ofrojnë mbështetje këtyre nxënësve.
- Të analizojnë se a ndihen të bullizuar nga ana e mësimdhënësve dhe nxënësve tjerë, nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë, apo ndihen të pranuar nga shoqëria e tyre.

Implikimet praktike nga studimi

Pavarësisht kufizimeve dhe mangësive të këtij punimi, përsëri mund të kemi disa implikime praktike kundrejtë mësimitdhënësve, studiuesve si dhe organeve më të larta arsimore.

Përmes këtij hulumtimi evidentuam gjendjen aktuale në arsim, specifikisht funksionit të inkluzionit në shkolla të rregullta në rajonin e qytetit të Prizrenit, si dhe njohuritë që kanë mësimitdhënësit e po të njejtit rajon për trajtimin e nxënësve të tillë. Duke marrë parasysh faktin se prevalenca e vështirësive në të nxënë ishte goxha e lartë, na bën të mendojmë se një situatë e tillë mbizotëron edhe në qytetet e tjera, pranda punimi mund të shërbejë për ndërgjegjësimin e grupeve të ndryshme njerëzish, të organizojnë trajnime mbi përsosjen profesionale të mësimitdhënësve për punën me fëmijët me vështirësi në të nxënë, duke qenë se shumica e tyre kanë shumë pak trajnime sa i përket këtyre vështirësive, si dhe në ndërkohë të organizojnë aktivitete me këta fëmijë të cilat ndikojnë në zbutjen e performancës së ulët akademike që tregojnë ata në klasë. Edhe pse si temë është trajtuar edhe më herët në vendin tonë, përsëri shpresoj se ky punim sado pak do të kontribuojë në fushën edukativo-arsimore.

REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE

- Agrilo, C. P. (2012). Evidence for two numerical systems that are similar in humans and guppies. *PlosONE*, vol 7 (2).
- Alarcon, M., Defries, J., Gillis Light, J., & Pennington, B. (1997). A twin study of mathematics disability. *Journal of Learning Disabilities*, 30 (6), p. 617-623.
- American Psychiatric Association. (2013). *DSM-V Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders (Fifth Edition)*. American Psychiatric Publishing.
- Barbiero, C. L. (2012). The submerged dyslexia iceberg: how many school children are not diagnosed? Results from an Italian study. *CENDi (National Committee on the Epidemiology of Dyslexia) working group, & Epidemiology of Dyslexia of Friuli Venezia Giulia working group (FVGwg)*, PloS one, 7(10), e48082.
- Bonifacci, P. M. (2013). Parents of Children with Dyslexia: Cognitive, Emotional, and Behavioural Profile. *Dyslexia an International Journal of research and Practice* .
- Brant, N. G. (2014). *Dysgraphia: A Parent's Guide to Understanding Dysgraphia and Helping a Dysgraphic Child*. New York: CreateSpace Independent Publishing Platform.
- Butterworth, B. (2011). Dyscalculia to brain from education. *Science*, vol 332.
- Carroll, J., Jonathan, & Shapiro, L. (2015). Predicting dyslexia using prereading skills: the role of sensorimotor and cognitive abilities. *The journal of Child Psychology and Psychiatry*, 57 (6), p. 750-758.
- Clark, K., Helland, T., Specht, K., Narr, K., & Mains, F. (2014). Neuroanatomical precursors of dyslexia identified from pre-reading through to age 11. *Brain, A Journal of Neurology*, 137(Pt 12), p. 3136-3141.
- Deuel, R. (1994). Developmental Dysgraphia and Motor skills Disorders. *Journal of Child Neurology*, Vol. 10, 6-8.
- Devolli, A. (2008). *Identifikimi i çrregullimeve në lexim dhe shkrim tek nxënësit e klasave të treta dhe të katërta të shkollës fillore*. Pristina: University "Hasan Prishtina".

- Döhla, D. &. (2016). Developmental Dyslexia and Dysgraphia: What can We Learn from the One About the Other? *Frontiers in psychology*, 6, 2045.
- Duff, F. J. (2014). Reading and language intervention for children at risk of dyslexia: a randomised controlled trial. *Journal of child psychology and psychiatry, and allied disciplines*, 55(11), 1234–1243.
- Dupoux, E. (2006). Teachers' attitudes toward integration of students with disabilities in Haiti and the United States. *International Journal of Disability, Development and Education*, 52(1), 43-58.
- Erickson, L. G. (2013). *Dislessia e altri DSA a scuola*. Edizioni Centro Studi Erickson.
- Erickson, L. G. (2017). *Discalculia e altre difficoltà in aritmetica a scuola*. Roma: Edizioni Centro Studi Erickson.
- Franklin, D. (2018). *Helping Your Child with Language Based Learning Disabilities*. Oakland: New Harbinger Publications, Inc.
- Franklin, D. (2018). *Strategies to succeed in school & life with dyslexia, dysgraphia, dyscalculia, ADHD & processing disorders*. Canada: Raincoast Books.
- Garuli, L. (2018). *Çrregullimet e të nxëniet*. Tiranë: Mirgeeralb.
- Gerondale, T. (2015, Qeshor 10). *Inclusive Schools Network*. Gjetur në TOGETHER WE LEARN BETTER: INCLUSIVE SCHOOLS BENEFIT ALL CHILDREN: <https://inclusiveschools.org/together-we-learn-better-inclusive-schools-benefit-all-children/>
- Goswami, U. (2015). Sensory theories of development dyslexia: three challenges for research. *Nature Reviews Neuroscience*, 16(1), p. 43-54.
- Gubbay, S. S. (1995). A study and review of developmental dysgraphia in relation to acquired dysgraphia. *Brain & development*, 17(1), 1–8.
- Hill, E. (2015). Executive difficulties in development coordination disorder: Methodological issues and future directions. *Current Developmental Disorders Reports*, 2(2):141-149.

- Lipsky, D. K. (1999). Inclusive education: a requirement of democratic society. 12.
- MASHT. (2014). *Arsimi Gjithëpërfshirës*. Prishtinë: MASHT.
- Mayes, S. D. (2019). High Prevalence of Dysgraphia in Elementary Through High School Students With ADHD and Autism. *Journal of attention disorders*, 23(8), 787–796.
- Mayes, S., & Calhoun, S. (2006). Frequency of reading, math, and writing disabilities in children with clinical disorders. *Learning and Individual Differences*, vol 16, 145-157.
- Milsom, A. G. (2010). Factors mediating the relationship between social skills and academic grades in a sample of students diagnosed with learning disabilities or emotional disturbance. *Remedial and special education*, 31(4), 241-251.
- NCLD. (2017, Mars 15). *Children and Adults with learning disabilities*. The National Center for Learning and Disabilities. Gjetur në Child Development: https://childdevelopmentinfo.com/wp-content/uploads/2014/12/ldchecklist.pdf?fbclid=IwAR1RBD82RxiWdkjCO0KM95CMbSlwzl4HcWUztONTeN-3oP2tcNWRbPXdD_s
- Nergard-Nilssen, T. H. (2014). Developmental dyslexia in adults: behavioural manifestations and cognitive correlates. *Dyslexia, an International Journal of Research and Practice*, 20(3):191-207,.
- Newman, T. (2017, Dhjetor 8). *What is dyspraxia?* Gjetur në Medical News Today: <https://www.medicalnewstoday.com/articles/151951>
- Nikoghosyan-Bossen, G. &. (2018). Diagnosis of developmental dyspraxia. *Ugeskrift for laeger*, 180(11).
- O'Hare, A. E. (1989). Childhood dysgraphia. Part 2. A study of hand function. *Child: care, health and development*, 15(3), 151–166.
- Parhiala, P. T. (2015). Psychosocial Functioning of Children with and without Dyslexia: A Follow-up Study from Ages Four to Nine. . *Dyslexia (Chichester, England)*, , 21(3), 197–211.

- Passolunghi, M. M. (2012). Selective spatial working memory impairment in a group of children with mathematics learning disabilities and poor problem solving skill. *Journal of Learning Disabilities*, 45, 342-351.
- Pierangelo, R. &. (2010). *Learning Disabilities: A Practical Approach to Foundations, Assessment, Diagnosis, and Teaching*. Pearson/ Allyn and Bacon.
- Pietrangelo, A. (2019, Shtator 26). *How Dyspraxia Differs from Other Development Delays in Children*. Gjetur në How Dyspraxia Differs from Other Development Delays in Children: <https://www.healthline.com/health/dyspraxia#childhood-symptoms>
- Pino, M. &. (2014). The inclusion of students with dyslexia in higher education: a systematic review using narrative synthesis. *Dyslexia (Chichester, England)*, 20(4), 346–369.
- Printz, T. M.-B. (2018). Verbal and oral dyspraxia in children and juveniles. *Ugeskrift for laeger*, 180(12).
- Reid, G. (2006). *E' disslesia!* Trento: Erickson.
- Robo, M. (2014). Social inclusion and inclusive education. *Academicus*, (10), 181-191.
- Savelli, E. S. (2011). *Dislessia evolutiva in pediatria - Guida alla diagnosi e al trattamento*. Trento: Erickson.
- Siok, W. T. (2008). A structural-functional basis for dyslexia in the Cortex of the Chinese readers. *PNAS*, 105, 5561-5566.
- Snowling, M. M.-L. (2016). Oral language deficitis in familial dyslexia: A meta analysis and review. *Psychological Bulletin*, 142(5), 498-545.
- Starkey, P. S. (1990). Numerical abstraction by human infants. *Cognition*, vol 36, 97-128.
- Stoianov, I. M. (2012). Emergence of a "visual number sense" in hierarchical generative models. *Nature Neurosience*, vol 15 (2), 194-196.
- UNICEF. (2017, Shtator). *Inclusive Education*. Gjetur në Inclusive Education: including children with disabilities in qualiy learning: what needs to be done?:

https://www.unicef.org/eca/sites/unicef.org.eca/files/IE_summary_accessible_220917_brief.pdf

- Van der Leij, A. V. (2013). Precursors of developmental dyslexia: An overview of the longitudinal dutch dyslexia programme study. *Dyslexia, an International Journal of Research and Practice*, 191-213.
- Vio, C. T. (2021). *Diagnosi dei disturbi specifici dell'apprendimento scolastico*. Trento: Erickson.
- Walker, E. S. (2018). Dyspraxia in clinical education: a review. *The clinical teacher*, 15(2), 98–103.
- Weiland, C. Y. (2013). Impact of a prekindergarten program on children's mathematics, language, literacy, executive function, and emotional skills. *Child development*, 84(6), 2112-2130.
- Wyn, K. (1995). The origins of the numerical knowledge. *Mathematical Cognition*, vol 1, 35-60.

SHTOJCA: PYETËSORI I MËSIMDHËNËSVE

Të nderuar mësimdhënës,

Unë jam Suada Kryeziu, studente nivelit Master në Fakultetin e Edukimit – drejtimi Edukim Inklusiv, të Universitetit “Hasan Prishtina” në Prishtinë. Në kuadër të punimit të diplomës me titull: *“Prevalenca e vështirësive në të nxënë tek nxënësit e ciklit fillor”*, së bashku me mentoren Prof. Ass. Dr. Ardita Devolli, kemi përkthyer dhe përshtatur këtë pyetësor me qëllim të mbledhjes së të dhënave të nevojshme për analizën empirike.

Ju drejtohem me kërkesën që të më ofroni përgjigjet e juaja lidhur me pyetjet e poshtëshënuara. Gjithashtu ju siguroj se është detyrimi im profesional e ligjor të ruaj konfidencialitetin e përgjigjeve tuaja. Ky pyetësor do të iu marrë 5 – 10 minuta kohë.

Pyetësori është i ndarë në dy pjesë: në pjesën e parë janë të përfshira të dhënat biosociale të mësimdhënësve ndërsa në pjesën e dytë janë pyetjet specifike të përpiluara enkas për këtë studim, është pyetësor i tipit të mbyllur me mundësi të zgjedhjes së përgjigjeve nga: (1) – *Nuk pajtohem* aspak deri në (5) – *Pajtohem plotësisht*.

Saktësia e rezultateve varet nga sinqeriteti juaj.

Parapakisht ju falenderojmë për bashkëpunimin!

I. Informata të përgjithshme

1. Emri i institucionit ku punoni: _____

2. Vendi ku punoni:

a) Fshat	
b) Qytet	

3. Cilës moshë i takoni:

a) 20 - 30 vjeç	
b) 31 - 40 vjeç	
c) 41 - 50 vjeç	
ç) 51 – 60 vjeç	
d) Mbi 60 vjeç	

4. Gjinia:

a) Femër	
----------	--

b) Mashkull	
-------------	--

5. Niveli i shkollimit:

a) Shkollë e lartë	
b) Baçelor	
c) Master	
d) Doktoratë	

6. Vitet e përvojës:

a) 1 vit	
b) 2 – 6 vite	
c) 10 vite	
d) më shumë se 10 vite	

7. Gjinia e fëmijës:

a) Fshat	
b) Qytet	

II. Prevalenca e vështirësive në të nxënë tek nxënësit e ciklit fillor

Ju lutem, duke pasur për bazë njohuritë dhe përvojën tuaj, klasifikoni me ✓ deklaratat e mëposhtme prej (1) deri në (5); për (1) (*Nuk pajtohem aspak*) dhe për (5) (*Pajtohem plotësisht*).

Nr.	<i>Deklarata</i>	<i>Pajtohem plotësisht</i>	<i>Pajtohem pjesërisht</i>	<i>Mesatarisht</i>	<i>Nuk pajtohem pjesërisht</i>	<i>Nuk pajtohem aspak</i>
1.	Ka vështirësi në organizimin e detyrave dhe aktiviteteve.					
2.	Shpërqendrohet lehtë nga ndikimet e jashtme.					
3.	I harron shpejtë aktivitetet e përditshme/rutinore.					
4.	Është i ngathët, derdh dhe rrëzon gjëra nga duart.					
5.	Nuk ka sukses me lojëra dhe aktivitete që kërkojnë koordinimin e syve me duart (p.sh., mësimet pianoje, basketbolli, bejsbolli).					
6.	Ka probleme me shtypje të butonave, në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme me grepa, kapëse, zinxhirë dhe nuk arrin të bëjë lidhjen e këpucëve.					
7.	Mban lapsin në mënyrë jo të duhur, duke rezultuar në shkrim të dobët.					
8.	Ka vështirësi në përdorimin e objekteve të vogla ose sendeve që kërkojnë saktësi (p.sh., lego, puzzle, pincetë, gërshërë).					
9.	Demonstron vonesa në të folur.					
10.	Ka vështirësi të ritregojë atë që sapo është thënë.					

11.	Demonstron të folur të ngadaltë dhe të ndërprerë, duke përdorur shumë shtesa (p.sh., uh, um, dhe, e dini, kështu).					
12.	Ngatërron fjalët që tingëllojnë të ngjashme me të tjerat.					
13.	Ka interes të kufizuar për libra ose tregime.					
14.	Ka vështirësi për të kuptuar udhëzimet e detyrave.					
15.	Ka vështirësi në njohjen dhe kuptimin e fjalëve të reja					
16.	Shpesh humbet vendin gjatë leximit.					
17.	Ndryshon rendin e shkronjave në fjalë, p.sh (jep-pej).					
18.	Ka probleme në emërtimin e shkronjave.					
19.	Zëvendëson ose shmang disa fjalë gjatë leximit.					
20.	Nuk i pëlqen të lexojë.					
21.	Demonstron vonesa në të mësuarit për të kopjuar dhe shkruar tekste të ndryshme.					
22.	Ka vështirësi të kujtojë si duken shkronjat dhe numrat.					
23.	Shpesh i përmbysë shkronjat, numrat dhe simbolet.					
24.	Kopjon nga tabela në mënyrë të pasaktë (p.sh., ngatërron shkronja dhe numra me pamje të ngjashme).					
25.	Ka vështirësi të shoqërohet me moshatarët.					
26.	Nuk reagon si duhet ndaj ngacmimeve.					
27.	Ka vështirësi me vetëkontrollin kur zhgënjehet.					
28.	Shfaq vështirësi në njohuritë mbi numrat (p.sh. njohja e madhësive pa numëruar).					

29.	Ka vështirësi për të mësuar dhe memorizuar faktet themelore të mbledhjes dhe zbritjes.					
30.	Rendit dobët numrat duke rezultuar në gabime llogaritëse.					
31.	Ka vështirësi me krahasimet (p.sh., më pak se, më e madhe se).					
32.	Ka vështirësi mbi konceptin e kalimit të kohës.					
33.	Ka vështirësi të numërojë shpejt ose të bëjë llogaritjet.					
34.	Ka probleme në të mësuarit e tabelave, formulave dhe rregullave të shumëzimit.					
35.	Nxënësit identifikohen lehtë me vështirësi në të nxënë.					
36.	Vështirësitë në të nxënë janë të lindura.					
37.	Angazhimi i mësimit zbut vështirësitë në të nxënë tek nxënësit.					
38.	Nxënësit shfaqin më shumë vështirësi në lexim.					
39.	Nxënësit shfaqin më shumë vështirësi në shkrim.					
40.	Nxënësit shfaqin më shumë vështirësi në matematikë.					
41.	Nxënësit shfaqin më shumë vështirësi në manipulimin e motorikës fine.					
42.	Mendoj se në shkollat tona janë të përhapura mjaft vështirësitë në të nxënë.					

Nënshkrimi i mësimit:

Data:
